



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 63

Tiranë – E martë, 19 prill 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 266, datë 6.4.2016	3919
Për miratimin e kontratës me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë të Republikës së Shqipërisë (e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore) dhe Albanides Energy sh.p.k., për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, Blloku 8.....	3919

**VENDIM**

Nr. 266, datë 6.4.2016

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS ME
NDARJE PRODHIMI, NDËRMJET
MINISTRISË SË ENERGJISË DHE
INDUSTRIË TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË (E PËRFAQËSUAR NGA
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE
NATYRORE) DHE ALBANIDES ENERGY
SHPK, PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN
DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE NË TOKË,
NË SHQIPËRI, BLOKU 8**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13, të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë të Republikës së Shqipërisë (e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore) dhe Albanides Energy sh.p.k., për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, blloku 8, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**KONTRATË ME NNDARJE PRODHIMI
PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE
PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË
SHQIPËRI, NË TOKË BLOKU 8,
NDËRMJET MINISTRISË ENERGJISË DHE
INDUSTRIË SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
(E PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE)
DHE ALBANIDES ENERGY SHPK**

Kjo Kontratë nënshkruhet në datën 15.3.2016 nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë së Shqipërisë (MEI) dhe Agjencia Kombëtare e

Burimeve Natyrore, që këtu më poshtë referohet si “AKBN”), në përputhje me ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993, i ndryshuar, “Për hidrokarburet”, përfaqësuar nga ministri dhe drejtori i hidrokarbureve të AKBN-së (në tekstin e mëtejme “Kontraktues”) dhe Albanides Energy sh.p.k., një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë degë dhe plotësisht e kontrolluar të Dinaric International Energy Ltd, shoqëri tregtare, e organizuar sipas ligjeve të Kanadasë, përfaqësuar nga administratorja e saj (që këtu më poshtë do të referohet si “Kontraktori”).

Në dëshmi të palëve këtu:

Ndërsa të gjitha burimet natyrore, duke përfshirë mineralet dhe hidrokarburet në Republikën e Shqipërisë janë pasuri e Shqipërisë;

Ndërsa operacionet hidrokarbure në Republikën e Shqipërisë, në përgjithësi u nënshtrohen ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe në qoftë se nuk përmendet ndryshe në këtë Kontratë, në përgjithësi nga ligjet dhe rregulloret e mëposhtme:

Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, i amenduar me ligjin nr. 7853, datë 29.7.1994, ligjin nr. 8297, datë 4.3.1998, “Për një ndryshim në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, ligjin nr. 19/2015 (që bashkërisht do të quhen “Ligji për hidrokarburet”);

Ligji nr. 7811, datë 12.4.1994, “Për aprovimin e dekretit nr. 782, datë 22.2.1994, “Mbi sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim prodhim)”, amenduar me ligji nr. 8345, datë 13.5.1998, ligjin nr. 8345, datë 13.5.1998, ligjin nr. 10049, datë 24.12.2008, ligjin nr. 32/2012, datë 21.3.2012, ligjin nr. 183/2013, datë 28.12.2013;

Ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”; dhe

Ligjin nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”; dhe

Ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”; dhe

Ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002, “Për akcizën”, amenduar me ligjin nr. 9163, datë 18.12.2003, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002, “Për akcizën”; ligji nr. 9041, datë 27.3.2003 dhe ligji nr. 9328, datë 6.12.2004, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002” (që bashkërisht do të quhen “Ligji i taksës së akcizës”); dhe

Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 547, datë



9.8.2006, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”; dhe

Ndërsa AKBN-ja është autorizuar nga nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë së Shqipërisë të ndjekë kryerjen e të gjitha operacionet hidrokarbure në Shqipëri, duke përfshirë kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin.

Ndërsa Kontraktori dëshiron të ndërmarrë të gjitha operacionet për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në të gjithë zonën e Kontratës, të përshkruar në anekset A dhe B të kësaj Kontrate dhe të plotësojë detyrimet e të gëzojë të drejtat që parashikohen në këtë Kontratë si një kontraktor i AKBN-së në përputhje me termat dhe kushtet që përmbahen në këtë Kontratë; dhe

Ndërsa qeveria e Republikës së Shqipërisë ka autorizuar AKBN-në që të lidhë këtë Kontratë me Kontraktorin për kryerjen e të gjitha operacioneve hidrokarbure që përshkruhen në këtë Kontratë,

bazuar në sa më sipër, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni I Përcaktimet

1.01 “Procedurë llogaritëse” do të thotë procedura që përcaktohet në akordancë me legjislacionin në fuqi në aneksin C të kësaj Kontrate dhe e cila përbën një pjesë integrale dhe të pandashme të saj.

1.02 “Filiat i kompanisë” do të thotë një kompani e varur, kompani mëmë ose kompani motër të një Pale ose një njësi që përbën një Palë. Për qëllimet e përcaktimit të mëparshëm:

1.02.1 Një kompani e varur është një kompani e kontrolluar nga një Palë ose një njësi që përmban një Palë;

1.02.2 Një kompani mëmë është një kompani që kontrollon një Palë ose një njësi që përmban një Palë;

1.02.3 Një kompani motër është një kompani që kontrollohet nga e njëjta kompani si një Palë ose një njësi që përmban një Palë.

Për qëllim të të cilit “Kontroll” do të thotë që një kompani zotëron pjesë të kapitalit, direkt ose indirekt nëpërmjet kompanive të tjera, që përfaqëson një shumicë të votave në mbledhjen e aksionarëve të kompanisë që është e kontrolluar.

1.03 “Shqipëri” do të thotë Republika e Shqipërisë.

1.03.1 “Qeveria e Shqipërisë” do të thotë “qeveria e Republikës së Shqipërisë”, përfshirë çdo departament, agjenci, ministri apo ndarje legjislative dhe politike apo instrument tjetër apo çdo autoritet tjetër qeveritar të Shqipërisë.

1.04 “Vlerësim” do të thotë ato punime për t’u kryer mbas një zbulimi nafte e gazi me qëllim për të përcaktuar më mirë parametrat e naftës e të gazit dhe të rezervuarit që lidhet me zbulimin dhe të përcaktojë leverdinë ekonomike të tij dhe përfshin, por nuk është i kufizuar, për:

a) shpimin e puseve dhe kryerjen e matjeve të prodhimit;

b) zgjedhjen e kampionëve gjeologjikë dhe fluideve të rezervuarit; dhe

c) kryerjen e studimeve shtesë dhe kryerjen e matjeve gjeofizike dhe të dhënave të tjera, si dhe përpunimin e disa të dhënave.

1.05 “Hidrokarbure të disponueshme” do të thotë sasia e prodhimit ditor të hidrokarbureve (minus ndonjë sasi të humbur, të përdorur në operacione, të djegur ose të rinjektuar) të prodhuar, të rikuperuar dhe të matur nga zona e Kontratës në pikën e matjes. Hidrokarburet e disponueshme mund të jenë naftë bruto e disponueshme dhe/ose gaz i disponueshëm, sipas rastit.

1.06 “Prodhim mesatar ditor” do të thotë prodhimi mesatar i naftës së disponueshme për çdo ditë gjatë një muaji kalendarik, i llogaritur nga pjesëtimi i sasisë së përgjithshme të hidrokarbureve të disponueshme të matura nga zona e Kontratës në pikën e matjes gjatë atij muaji kalendarik, me numrin e ditëve në atë muaj kalendarik. Për muajin kalendarik në të cilin verifikohet data e fillimit të prodhimit komercial, këto hidrokarbure të disponueshme do të pjesëtohen me numrin e ditëve të atij muaji kalendarik në vazhdim, duke përfshirë datën e fillimit të prodhimit komercial.

1.07 “Fuçi” do të thotë dyzet e dy (42) gallonë US (ekuivalent me afërsisht 158.984 litër), masë lëngu, e korrektuar në temperaturë 60 (gjashtëdhjetë) gradë Fahrenheit, me presion në nivelin e detit prej 1.01325 bar.

1.08 “BOE” do të thotë fuçi ekuivalente nafte bruto.

1.09 “BOPD” do të thotë fuçi nafte bruto në ditë.

1.10 “BPD” do të thotë fuçi në ditë dhe do të përfshijë si BOPD-në ashtu dhe BOE-në.



1.11 “BTU” do të thotë një mijë e pesëdhjetë e pesë presje pesëdhjetë ë gjashtë (1,055.056) Joule.

1.12 “Buxhet” do të thotë një vlerësim i kostove të kërkuara për të kryer operacionet hidrokarbure në përputhje me programin e punës së aprovuar.

1.13 “Muaj kalendarik” do të thotë secili nga 12 (dymbëdhjetë) muajt e vitit kalendarik.

1.14 “Tremujor kalendarik” ose “tremujor” do të thotë një periudhë prej 3 (tre) muajsh konsektivë, që fillojnë në ditën e parë të janarit, prillit, korrikut dhe tetorit të çdo viti kalendarik.

1.15 “Vit kalendarik” do të thotë një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh kalendarikë konsektivë, sipas kalendarit gregorian, që fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetorin pasues, duke i përfshirë të dyja datat.

1.16 “Zbulim komercial” do të thotë zbulimi i një grumbullimi hidrokarbure, i cili, sipas opinionit të kontraktorit, mund të shfrytëzohet ekonomikisht, në përputhje me këtë Kontratë.

1.17 “Kontratë” do të thotë kjo Kontratë, duke përfshirë anekset e saj, siç mund të amendohet kohë pas kohe, me marrëveshje mes të dyja palëve.

1.18 “Kontraktor” do të thotë Albanides Energy sh.p.k. ose pasuesit e tij respektivë dhe çdo mbajtës i ndonjë interesi pjesëmarrës, në përputhje me nenin XIX.

1.19 “Zonë e Kontratës” do të thotë në datën efektive zona e përshkruar në aneksin A dhe e përcaktuar në hartën bashkangjitur si aneks B të kësaj Kontrate, siç mund të ndryshohet nga pjesët që Kontraktori do të lëshojë në përputhje me këtë Kontratë.

1.20 “Hidrokarbure për mbulimin e kostos” do të thotë pjesa e hidrokarbureve të disponueshme, e përcaktuar në përputhje me paragrafin 7.1 të kësaj Kontrate.

1.20.1.1 “Kosto të aprovuara” do të thotë kostot e përcaktuara si në përputhje me paragrafin 4, të nenit 1, të procedurës së kontabilitetit.

1.21 “Naftë bruto” do të thotë çdo hidrokarbur i prodhuar nga zona e Kontratës dhe e cila, në grykën e pusit ose në separator, është në gjendje të lëngshme duke përfshirë, por pa u kufizuar, naftën bruto, lëngjet natyrale të gazit dhe kondensatet, të cilat janë të stabilizuar ose që janë kthyer dhe trajtuar në mënyra të tjera, në qoftë se është e nevojshme, për t'i bërë ato të përshtatshme për transportim.

1.22 “Detyrimet doganore”, siç përdoren këtu,

do të përfshijnë të gjitha taksat, detyrimet, tatimet, tarifat, të drejtat ose çdo detyrim tjetër financiar që mund të jetë rezultat i importimit të njësisë apo njësisë të referuara në nenin XII të kësaj Kontrate.

1.23 “Datë e zbulimit komercial” do të thotë data në të cilën Kontraktori njofton me shkrim AKBN-në, për një zbulim komercial në përputhje me paragrafin 6.4.1 të kësaj Kontrate.

1.24 “Datë e zbulimit” të një vendburimi, është data në të cilën një pus në të cilin është bërë një zbulim, është kompletuar dhe testuar.

1.25 “Datë e fillimit të prodhimit komercial” do të thotë data në të cilën është bërë dërgesa e parë e rregullt e hidrokarbureve nga një zbulim komercial në pikën e matjes në përputhje me një plan zhvillimi dhe nuk do të përfshijë dërgesën e prodhimit të testimit ose të testimit të zgjatur.

1.26 “Ditë” ose “ditë” do të thotë një periudhë prej 24 (njëzet e katër) orësh, duke filluar nga ora 00:00 dhe duke përfunduar në orën 24:00 (njëzet e katër), sipas orës shqiptare.

1.27 “Zbulim” do të thotë çdo zbulim i grumbullimeve të hidrokarbureve, si rezultat i kryerjes së një aktiviteti shpimi të një strukture gjeologjike, e cila, pas testimit në përputhje me praktikën e njohura dhe të pranuar në industrinë ndërkombëtare të hidrokarbureve, gjykohet nga Kontraktori që të jetë e aftë të prodhojë hidrokarbure.

1.28 “Zonë zbulimi” do të thotë një zonë ose zona që Kontraktori mund t'i përcaktojë në çdo kohë përpara përfundimit të periudhës së kërkimit, duke njoftuar AKBN-në që Kontraktori ka bërë një zbulim dhe duke i dhënë AKBN-së hartën që tregon kufijtë që përcaktojnë pjesën e zonës së Kontratës ku Kontraktori beson se ndodhet zbulimi. Pasi përcaktohet në përputhje me nenin VI, një zonë zbulimi do të shtrihet në të gjitha thellësitë brenda kufijve të saj anësorë.

1.29 “Pikë livrimi” do të thotë çdo pikë, brenda Republikës së Shqipërisë, siç mund të bihet dakord mes Palëve, ku secila prej Palëve merr pjesën e tij respektive të hidrokarbureve për rikuperimin e kostos dhe hidrokarbureve fitim. Pika e livrimit mund të jetë e njëjtë ose jo me pikën e matjes.

1.30 “Zhvillim” do të thotë dhe do të përfshijë, por pa u kufizuar në to, të gjitha operacionet dhe aktivitetet në përputhje me planet e zhvillimit, programet e punës dhe buxhetet e aprovuara sipas kësaj Kontrate në lidhje me:



1.30.1 Shpimin, tamponimin, devijimin, thellimin dhe kompletimin e pajisjes e pusit për qëllimin e prodhimit dhe ndryshimin e statusit të një pusi të tillë; dhe

1.30.2 Projektimin, ndërtimin, instalimin dhe operimin (brenda ose jashtë zonës së Kontratës) të pajisjeve; platformave; tubacioneve; sistemeve të ujit, elektrike dhe sistemeve të tjera; pajisjeve (duke përfshirë pajisjet portuale të stokimit dhe ngarkimit); impiantet sipas nevojës së prodhimit nga pusi për marrjen, ruajtjen, trajtimin, stokimin, djegien, transportimin dhe livrimin e hidrokarbureve për eksport dhe për tregun vendas; dhe për të ndërmarrë injektimin ose riinjektimin dhe projektet e tjera dytësore të naftënxyrjes. Përdorimi i termit “zhvillim” në këtë Kontratë do të përfshijë prodhimin, siç përcaktohet në këtë Kontratë, kur do të jetë e përshtatshme sipas kontekstit dhe rrethanave.

Folja “zhvillon” do të thotë të kryesh zhvillim.

1.31 “Zona e zhvillimit dhe prodhimit” do të thotë zona e përcaktuar nga Kontraktori në përputhje me nenin 1.33, në çdo kohë para përfundimit të periudhës së kërkimit, duke njoftuar AKBN-në që Kontraktori ka bërë një zbulim komercial dhe duke i dhënë AKBN-së hartën që përshkruan zonën që përfshin të gjithë ose një pjesë të zonës së zbulimit, një zonë zhvillimi dhe prodhimi mund të konsistojë në më shumë se një zonë jo e vazhdueshme.

1.32 “Shpenzime zhvillimi” do të thotë të gjitha kostot direkte ose indirekte dhe shpenzimet për zhvillimin dhe prodhimin, me përjashtim të shpenzimeve operative.

1.33 “Plan zhvillimi” do të thotë një plan i paraqitur nga Kontraktori dhe i aprovuar nga AKBN-ja për zhvillimin e një zbulimi pas ndonjë vlerësimi të zbulimit, përmbajtja e të cilit do të përfshijë, por pa u kufizuar në to, si më poshtë:

a) detajet e të gjitha aktiviteteve të kërkimit të kryera në kuadër të këtij zbulimi dhe të gjithë informacionin e përdorur për vlerësim, detajet e strukturës gjeologjike, përmbajtjen hidrokarbure dhe stratigrafinë dhe detajet e një vlerësimi të mëtejshëm, siç mund të kërkohet nga Kontraktori;

b) volumet e vlerësuar të naftës dhe/ose gazit që gjendet fillimisht në shtresë dhe vlerësimin e sasisë së nxjerrshme, mekanizmat e pritshëm të nxjerrjes dhe koeficienti i naftënxyrjes, hapësirat e drenimit, politika me të cilën mendohet të operohet

në rezervuar dhe qëllimi për metodat e dyta;

c) detaje të plota për pajisjet ose strukturat dhe punime të tjera që Kontraktori propozon të ndërtojë ose të kryejë gjatë periudhës së zhvillimit dhe prodhimit për këtë zbulim me qëllim prodhimin e naftës dhe/ose gazit nga ky zbulim dhe për minimizimin e djegies së gazit dhe parandalimin e ndotjes së mjedisit;

d) vendndodhjen dhe qëllimin për të cilin pajisjet, strukturat apo punime të tjera do të përdoren dhe kohën në të cilën çdo pajisje, strukturë apo punim tjetër do të fillojë dhe përfundojë;

e) vlerësimi i Kontraktorit për marketingun e hidrokarbureve, sasi të maksimale dhe minimale të hidrokarbureve, të cilat Kontraktori pret që të nxjerrë nga ky zbulim në çdo vit të periudhës së prodhimit të lidhur me të, koeficienti i pritshëm i rikuperimit dhe detajet e çdo problemi të pritshëm që të ndeshet gjatë prodhimit dhe marketingut;

f) detajet e shpenzimeve të pritshme vjetore dhe *cash flow* i shpenzimeve kapitale dhe operative; dhe

g) rezervat për minimizimin e shkarkimeve të gazit, programin e mbajtjes së presionit për optimizimin e nxjerrjes së hidrokarbureve dhe zhvillimit shtesë;

h) një vlerësim i arsyeshëm i kohës së nevojshme për kryerjen e planit të zhvillimit;

i) pikat e matjes dhe pikat e livrimit perspektive;

j) detajet e zonës së zhvillimit dhe prodhimit dhe shtrirja e zonës së zhvillimit dhe prodhimit të propozuar në lidhje me zbulimin komercial, zonë e cila duhet t'i korrespondojë projektimit sipërfaqësor të shtrirjes gjeologjike të zbulimit komercial në zonat që janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme dhe për t'u përcaktuar si zona e zhvillimit dhe prodhimit për zbulimin komercial në diskutim.

1.34 “Dollarë” ose simboli “\$” do të thotë dollarët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

1.35 “Data efektive” do të thotë, për këtë Kontratë, data në të cilën vendimi i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që aprovon këtë Kontratë, hyn në fuqi.

1.36 “Nafta e fitim” do të thotë sasia e hidrokarbureve të disponueshme të përcaktuara sipas paragrafit 7.6 të kësaj Kontrate.

1.37 “Ekspert” do të thotë një individ, i cili nuk është rezident ose shtetas i Shqipërisë dhe as nuk ka qenë i punësuar i Kontraktorit ose AKBN-së dhe as është rezident ose shtetas i shtetit ku është i



regjistruar Kontraktori ose i ndonjë dege apo përfaqësie të tij, i cili me anë të trajnimeve dhe eksperiencës së gjerë ka zhvilluar njohuri të thella në fushën teknike në të cilën shtrihet konflikti ose mosmarrëveshja, të cilën ky individ duhet të zgjidhë dhe i cili është emëruar në përputhje me parashikimet respektive të kësaj Kontrate.

1.38 “Kërkim” do të thotë operacione hidrokarbure, të cilat kryhen sipas kësaj Kontrate gjatë periudhës së kërkimit për ose në lidhje me kërkimin për hidrokarbure, duke përfshirë, por pa u kufizuar, vrojtime dhe studime gjeologjike, gjeofizike dhe të tjera, shikimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave, shpimin e puseve të kërkimit, planet që i shoqërojnë ato, operacionet e projektimit, administrative, inxhinierike, të ndërtimit dhe mirëmbajtjes dhe të gjitha operacionet dhe aktivitetet e tjera të lidhura me to të referuara në aneksin C ose të përcaktuara në ndonjë mënyrë tjetër në parashikimet e kësaj Kontrate.

Folja “kërkoj” do të thotë të kryesh kërkim.

1.39 “Shpenzime kërkimi” do të thotë të gjitha kostot direkte dhe indirekte dhe shpenzimet për kërkim.

1.40 “Periudhë kërkimi” do të thotë periudha e parë e kërkimit, periudha e dytë e kërkimit dhe periudha e tretë e kërkimit, të përcaktuara respektivisht në paragrafët 4.1.1, 4.1.2 dhe 4.1.3.

1.41 Pus kërkimi, pus vlerësimi dhe pus strukturor

“Pus kërkimi” do të thotë çdo pus i shpuar me qëllim për të konfirmuar një strukturë apo një element gjeologjik të veçantë në të cilën nuk është kryer më parë ndonjë zbulim nga Kontraktori.

“Pus vlerësimi” do të thotë çdo pus qëllimi i të cilit në kohën e fillimit të shpimit, është përcaktimi i shtrirjes ose volumit të rezervave të hidrokarbureve që ndodhen në një zbulim.

Pus strukturor do të thotë një pus i vendosur për t’u shpuar mbi një objekt gjeologjik nga i cili nuk është zbuluar naftë apo gaz ekonomikisht i dobishëm.

1.42 “Vit financiar” do të thotë viti financiar që fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetorin pasues, duke përfshirë të dyja datat.

1.43 “Forcë madhore” do të thotë akti që shkakton një vonësë në kryerjen ose pengesa në plotësimin nga njëra Palë të detyrimeve të saja sipas kësaj Kontrate, të cilat ndodhin nga rrethana jashtë

kontrollit dhe pa dështimin apo neglizhencën e kësaj Pale, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në aktet e Zotit ose të armiqve publikë, kushteve ekstreme të motit, difekte mekanike, rrezik për lundrim, zjarr, konflikte, luftë (e deklaruar ose e pa deklaruar), bllokim, greva, revolta, rebelime, kufizime karantine, epidemira, tërmete ose aksidente. Në asnjë rast mungesa e fondeve nuk do të përbëjë rast të forcës madhore.

1.44 “Gaz” do të thotë gazi natyral, si gazi shoqërues ashtu dhe ai jo shoqërues dhe të gjitha elementet përbërëse të tij të prodhuara nga çdo pus në zonën e Kontratës dhe të gjitha substancat johidrokarbure që ndodhen aty. Gaz përfshin gazin hidrokarbur të lëngëzuar (LPG), i cili është një përzierje kryesisht e butanit dhe propanit të lëngëzuar në presion dhe temperaturë.

1.45 “Praktika të mira ndërkombëtare të industrisë së naftës” do të thotë ato praktika, metoda, standarde dhe procedura përgjithësisht të pranuar dhe të zbatuara në shkallë ndërkombëtare nga operatorë të kujdesshëm, të ndërgjegjshëm, të aftë dhe me eksperiencë, në operacionet e kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit të naftës dhe të cilat në një moment të caktuar kohe në diskutim, në zbatim të një gjykimi të arsyeshëm nën dritën e fakteve të njohura në atë kohë, është marrë një vendim, pritet që të sjellin rezultatet e dëshiruara dhe qëllimin e përcaktuar në lidhje me të cilin praktikën, metodat, standardet, procedurat dhe rregullat e sigurisë, siç mund të jetë rasti, janë ndjekur; duke marrë në konsideratë se, megjithatë, “Praktikat e mira ndërkombëtare të industrisë së naftës” nuk nënkuptohet që të jenë të kufizuara në praktikën ose metodat optimale, duke përjashtuar të gjitha të tjerat, por më shumë duke qenë një spektër i praktikave, metodave, standardeve, procedurave dhe rregullave të sigurisë, të arsyeshme dhe të matura. Këto praktika do të zbatohen për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me parashikimet e kësaj Kontrate dhe me ligjin shqiptar të zbatueshëm.

1.46 “Mbushja e linjave” do të thotë ato hidrokarbure të përcaktuara në përputhje me paragrafin 7.7 të kësaj Kontrate.

1.47 “MCF” do të thotë një mijë (1,000) këmbë kub standard (SCF). Një (1) SCF është sasia e gazit të nevojshëm e nevojshme për të mbushur një këmbë kub hapësirë në presion atmosferik prej



14.65 paundë presion për inc katror absolut në një temperaturë bazë prej 60 (gjashtëdhjetë) gradë Fahrenheit.

1.48 “Pikë matjeje” do të thotë vendi ose vendet, për të cilat AKBN-ja dhe Kontraktori kanë rënë dakord, ku do të vendosen pajisje dhe mjete të përshtatshme për qëllim të kryerjes së të gjitha matjeve volumetrike dhe përcaktimeve të tjera, temperaturës dhe rregullimeve të tjera, përcaktimit të përmbajtjes së ujit dhe sedimentit dhe matjeve të tjera të nevojshme për të përcaktuar, për qëllime të ndryshme të kësaj Kontrate, volumet e hidrokarbureve të disponueshme. Të gjitha matjet dhe përcaktimet e përmendura më sipër do të konfirmohen me shkrim nga përfaqësuesit e AKBN-së dhe Kontraktorit në pikën e matjes. Pika e matjes mund ose mund të mos jetë e njëjtë me pikën e livrimit.

1.49 “MMBUT” do të thotë një milion (1,000,000) BTU.

1.50 “Mua” do të thotë një periudhë e numëruar nga një ditë e një muaji kalendarik, duke përfunduar në të njëjtën ditë të muajit kalendarik pasardhës ose, në qoftë se kjo nuk ekziston, në ditën e fundit të këtij muaji kalendarik.

1.51 “Shpenzime operative” do të thotë të gjitha kostot dhe shpenzimet direkte dhe indirekte, të bëra pas datës së fillimit të prodhimit komercial, kosto dhe shpenzime të cilat nuk janë normalisht të diskontueshme, duke përfshirë operimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e të gjitha llojeve të pajisjeve të kërkuara për operacionet hidrokarbure, duke përfshirë, por pa u kufizuar, kostot për shëndetin e njerëzve, sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit. Shpenzimet operative do të përfshijnë remontin, riparimin dhe mirëmbajtjen e aseteve, por nuk do të përfshijë ndonjë nga të mëposhtmet: devijimin, rishpimin dhe ndryshimin e statusit të pusit, zëvendësimin e aseteve ose të një pjese të një asemi, shtesat, përmirësimet ose rinovimet që zgjasin jetën e aseteve.

1.52 “Operator” do të thotë një njësi e caktuar nga Kontraktori dhe e aprovuar nga AKBN-ja, që të jetë përgjegjës për kryerjen e operacioneve hidrokarbure në zonën e Kontratës ose në një pjesë të saj sipas termave të kësaj Kontrate. Emërimi i një pasuesi të operatorit do të jetë subjekt i një miratimi paraprak nga AKBN-ja, duke marrë në konsideratë që ky aprovim nuk kërkohet dhe do të bëhet vetëm një njoftim me shkrim, në qoftë se

operatori pasues është një kompani filial.

1.53 “Interes pjesëmarrjeje” do të thotë interesat respektive të pandashme të mbajtura nga secila prej njërive që mund të përbejnë Kontraktorin në një kohë të caktuar.

1.54 “Palët” do të thotë AKBN-ja dhe Kontraktori dhe “Palë” do të thotë secila prej Palëve, duke përfshirë pasuesit respektivë të tyre.

1.55 “Hidrokarbure” do të thotë kolektivisht dhe individualisht, siç e kërkon konteksti, naftë bruto dhe gaz, si dhe ato substanca që prodhohen bashkë me to ose që ndahen prej tyre.

1.56 “Operacione hidrokarbure” do të thotë të gjithë ose ndonjë nga operacionet e lidhura me kërkimin, zhvillimin, nxjerrjen, prodhimin, ndarjen dhe trajtimin, magazinimin dhe transportimin dhe shitjen ose disponimin e hidrokarbureve deri në pikën e livrimit në Shqipëri.

1.57 “Prodhim” do të thotë çdo lloj operimi për prodhimin e hidrokarbureve dhe operimin e puseve të zhvillimit pas fillimit të prodhimit dhe marrjen, ruajtjen, trajtimin, magazinimin, transportimin, matjen dhe livrimin e hidrokarbureve, injektimin dhe riinjektimin dhe çdo tip tjetër operacionesh për nxjerrjen primare dhe sekondare të hidrokarbureve dhe transportimin, magazinimin dhe ndonjë punë ose aktivitet tjetër të nevojshëm ose ndihmës për operacione të tilla. Folja “prodhon” do të thotë të kryesh prodhim.

1.58 “Kosto të refuzuara” do të thotë ato kosto të përcaktuara në përputhje me paragrafin e dytë të paragrafit 4.10 të kësaj Kontrate.

1.59 “Rezervuar” do të thotë një shtresë poroze ose me çarje dhe e përshkueshme, në gjendje që të prodhojë hidrokarbure dhe e cila duhet konsideruar, për shkak të karakterit të substancave që mban (e ngjashme nga karakteristikat fizike, densiteti, koeficienti gaz-naftë, viskoziteti dhe një lidhje presioni) si një njësi në lidhje me shfrytëzimin e tij natyral.

1.60 “Situacion i mbulimit të koston” do të thotë situacioni i referuar në paragrafin 1 të nenit III të procedurës llogaritëse.

1.61 “Kosto të pezulluara” do të thotë ato kosto të përcaktuara në përputhje me paragrafin e parë të paragrafit 4.10 të kësaj Kontrate.

1.62 “Vit tatimor” do të thotë periudha 12-mujore (dymbëdhjetëmujore) sipas kalendarit gregorian, duke filluar më 1 janar dhe duke përfunduar më 31 dhjetor, duke përfshirë të dyja



datat, për të cilat kërkohen raportet për taksat në lidhje me ndonjë taksë të aplikueshme, sipas ligjeve apo rregullave në Shqipëri, për të ardhurat, fitimet ose të tjera.

1.63 “Përfundimi” do të thotë fundi i kësaj Kontrate me përfundimin e termave të aplikueshëm kontraktualë, sipas veprimit të parashikimeve të nenit XXIV ose me marrëveshje të shkruar të dyanshme të Palëve.

1.64 “Program pune” do të thotë një program, siç përcaktohet në nenin IV ose në parashikime të tjera të kësaj Kontrate dhe, në qoftë se konteksti nuk tregon ndryshe, do t’i referohet së njëjtës siç mund të amendohet ose plotësohet.

1.65 “Vit kontraktor” do të thotë një periudhë 12-mujore (dymbëdhjetëmujore) konsektive, duke filluar nga data efektive.

1.66 “Renta minerare” do të thotë taksa e përcaktuar në përputhje me ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”.

Neni II

Anekset e Kontratës

2.1 Aneksi A është një përshkrim i zonës së Kontratës në datën efektive.

2.2 Aneksi B është një hartë që tregon zonën e Kontratës në datën efektive.

2.3 Aneksi C është procedura e kontabilitetit.

2.4 Aneksi D është procedura për caktimin e çmimit të gazit.

2.5 Aneksi E është forma e garancisë bankare.

2.6 Anekset A, B, C, D dhe E të kësaj Kontrate janë bërë pjesë e kësaj Kontrate, dhe ato do të konsiderohen të kenë fuqi dhe efekt të barabartë me dispozitat e kësaj Kontrate. Megjithatë, në rast të ndonjë konflikti ndërmjet anekseve dhe tekstit të Kontratës, teksti i kësaj Kontrate do të mbizotërojë.

Neni III

Afatet, dhënia e të drejtave dhe pagesa e kostove

3.1 Në qoftë se nuk përfundohet më parë, në përputhje me termat e saj, kjo Kontratë do të qëndrojë në fuqi gjatë periudhës së kërkimit, periudhës së vlerësimit dhe çdo periudhe zhvillimi dhe prodhimi.

3.2 AKBN-ja nëpërmjet kësaj Kontrate i jep Kontraktorit të drejtën ekskluzive për kërkim, zhvillim dhe prodhim të hidrokarbureve në zonën e Kontratës, në varësi të termave dhe kushteve të kësaj Kontrate.

3.3 Interesat e pjesëmarrjes të secilën prej njësisve, që përbëjnë Kontraktorin, në varësi të nenit XIX, janë si më poshtë: Albanides Energy sh.p.k. 100%

3.4 Kontraktori do të paguajë 100% të të gjitha kostove dhe shpenzimeve që lidhen me kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga zona e Kontratës, në vartësi të dispozitave të mbulimit të kostos së kësaj Kontrate.

Neni IV

Periudha e kërkimit, programi i punës dhe shpenzimet e parashikuara

4.1 Brenda 3 (tre) muajsh nga data efektive, Kontraktori do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të filluar kryerjen e programit minimum të mëposhtëm të punës që mbulon atë periudhë kohe, bashkërisht të referuar si “Periudhë kërkimi”:

4.1.1 Periudha e parë e kërkimit (3 vjet nga data efektive)

Kontraktori do të kryejë programin minimum të mëposhtëm të punës gjatë 3 (tre) vjetëve fillestarë të periudhës së kërkimit (periudha e parë e kërkimit):

Nr.	Programi minimal i punës	Shpenzimet minimale në USD
1	G&G	550,000.00
2	Matje gravimetrike (rrjeti 1 km dhe shkalla 1:200 000) për gjithë bllokun	650,000.00
3	HSE & Studimi i ndikimit në mjedis	200,000.00
	Detyrimi total	1,400,000.00

Punime gjeologjiko-gjeofizike (G&G): Vlerësimi i të gjitha të dhënave ekzistuese dhe atyre fushore. Punimet fushore do të përfshijnë kampionimin për analiza sedimentologjike, stratigrafike dhe karbonit

organik të përgjithshëm, analizat fillestare për të përcaktuar tipin e Kerogjenit.

Vrojtimet të domosdoshme strukturore për të gjetur shkëmbinjtë mëmë dhe rezervuarë në



mbihipjet e ndryshme me moshë triasik-jurasike.

Rivlerësim të të gjitha të dhënave ekzistuese dhe punës laboratorike. Marrja dhe interpretimi i të dhënave fushore gjeologjike që lidhen me zonën e Kontratës, duke përfshirë studime gjeologjike dhe strukturore (hartografime, profile të balancuar) të përcaktuara nga kontraktori që kanë lidhje me analizat gjeologjike të zonës së Kontratës në përputhje me programin e punës dhe buxhetit.

Regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave gravimetrike të reja, si dhe marshutat fushore gjeologjike për të vlerësuar objektet e kërkimit dhe kryerjen e analizave të çarjeve për të vlerësuar karakteristikat e rezervuarit.

Gjatë fazës së parë të kërkimit, përveç përbushjes së programit minimum të punës të përcaktuar në nenin 4.1.1 Kontraktori mund të zgjedhë që të ndërmarrë punë kërkimore shtesë, përfshirë, por pa u kufizuar në, shpimin e një pusi/eve shtesë, punimeve dhe përpunimeve sizmike, punë gjeologjike në fushë dhe studime mekanike të shkëmbinjve.

Nr.	Programi minimal i punës	Shpenzimet minimale në USD
1	G&G	300,000.00
2	Punime të reja sizmike 150 km (2D)	1,500,000.00
3	Detyrimi total	1,800,000.00

G&G: Studime regjionale gjeologjike dhe strukturore (hartografime profile tërthore të balancuara etj.) Kryerja dhe përpunimi i sizmik fushor 2D.

Gjatë fazës së dytë të kërkimit, përveç përbushjes së programit minimum të punës të përcaktuar në nenin 4.1.1 Kontraktori mund të zgjedhë që të ndërmarrë punë shtesë kërkimore, përfshirë, por pa u kufizuar në, shpimin e një pusi/eve shtesë, punimeve dhe përpunimeve sizmike, punë gjeologjike në fushë dhe studime mekanike të shkëmbinjve.

Puna kërkimore shtesë duhet t'i paraqitet AKBN-së për aprovim, aprovim i cili nuk do të refuzohet pa arsye.

4.1.3 Periudha e tretë e kërkimit (2 vjet)

Me kusht që të ketë përfunduar programin

Puna kërkimore shtesë duhet t'i paraqitet AKBN-së për aprovim, aprovim i cili nuk do të refuzohet pa arsye.

4.1.2 Periudha e dytë e kërkimit (2 vjet)

Me kusht që të ketë përfunduar programin minimum të punës për periudhën e parë të kërkimit ose t'i ketë paguar AKBN-së shumën në dollarë në përputhje me paragrafin 4.1.4 të kësaj Kontrate, Kontraktori do të ketë alternativën e zgjatjes së periudhës së kërkimit për një periudhë shtesë prej dy (2) vjetësh (periudha e dytë e kërkimit). Kjo alternativë mund të ushtrohet nga Kontraktori, duke i dhënë AKBN-së njoftim me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para mbarimit të periudhës së parë të kërkimit, për: i) zgjedhjen e tyre për të hyrë në periudhën e dytë të kërkimit; dhe ii) angazhimin e tyre për të kryer programin minimum të mëposhtëm të punës gjatë periudhës së dytë të kërkimit:

minimum të punës për periudhën e dytë të kërkimit ose t'i ketë paguar AKBN-së shumën në dollarë në përputhje me paragrafin 4.1.4 të kësaj Kontrate, Kontraktori do të ketë alternativën e zgjatjes së periudhës së kërkimit për një periudhë shtesë prej 2 (dy) vjetësh (periudha e tretë e kërkimit) nëse, sipas miratimit nga AKBN-ja, ka rrethana të veçanta që kërkojnë më shumë kohë për Kontraktorin që të kryejë aktivitetin e mjaftueshëm të kërkimit. Kjo alternativë mund të ushtrohet nga Kontraktori, duke i dhënë AKBN-së njoftim me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para mbarimit të periudhës së dytë të kërkimit, për: i) zgjedhjen e tij për të hyrë në periudhën e tretë të kërkimit; dhe ii) detyrimin e tij për të kryer programin minimal të mëposhtëm të punës gjatë periudhës së tretë të kërkimit.

Nr.	Programi minimal i punës	Shpenzimet minimale në USD
1	G&G	100,000.00
2	Pus kërkimi 2000 m vertikal	2,000,000.00
3	Detyrimi total	2,100,000.00



Pus kërkimi: Një pus në një thellësi vertikale minimale 2.000 metra,

Gjatë fazës së tretë të kërkimit, përveç përmbushjes së programit minimum të punës të përcaktuar në nenin 4.1.1 Kontraktori mund të zgjedhë që të ndër marrë punë shtesë kërkimore, përfshirë, por pa u kufizuar në, çmimin e një pusi/eve shtesë, punimeve dhe përpunimeve sizmike, punë gjeologjike në fushë dhe studime mekanike të shkëmbinjve.

Puna kërkimore shtesë duhet t'i paraqitet AKBN-së për aprovim, aprovim i cili nuk do të refuzohet pa arsye.

4.1.4 Nëse Kontraktori nuk arrin në kohë:

1. Të realizojë punimet e reja dhe përpunimin e shumës së nevojshme të të dhënave gravimetrike, siç kërkohet në nenin 4.11, Kontraktori do t'i paguajë AKBN-së një shumë në USDollar e barabartë me volumin e përealizuar të pjesës së çdo dhe të gjithë komponentëve të programit përkatës minimal të punës, të fazës përkatëse të kërkimit, në varësi të rrethanave faktike.

2. Të realizojë një detyrim kryesor për kryerjen e punimeve të reja sizmike dhe përpunimin, të shumës së nevojshme të të dhënave sizmike 2D, siç kërkohet në nenin 4.1.2, Kontraktori do t'i paguajë AKBN-së një shumë në USDollar 10 000 (ten thousand) për çdo kilometër 2D të përealizuar në terren.

3. Të realizojë shpimin e një pusi kërkimi apo pas kryerjes së shpimit të një pusi kërkimi të detyrueshëm, braktis pusin pa e kompletuar apo pa arritur shpenzimet minimale për këtë pus, Kontraktori do t'i paguajë AKBN-së shpenzimet minimale në rastin kur shpimi i pusit nuk ka filluar apo diferencën e shpenzimeve minimale në rastin kur pusi braktiset.

4.2 Kontraktori do të ketë të drejtën të mbulojë çdo shpenzim të kryer për të përmbushur programin e tij të punës si shpenzime kërkimi në mënyrën e parashikuar në nenin VII.

4.3 Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Kontrate, periudha e parë e kërkimit, periudha e dytë e kërkimit ose periudha e tretë e kërkimit, do të zgjatet automatikisht me periudhën e kohës së nevojshme për të lejuar: 1. përfundimin e shpimit apo testimin të një pusi; dhe/ose 2. vlerësimin e rezultateve nga shpimi apo testimi i një pusi, megjithatë me kusht që një periudhë e tillë

vlerësimi të mos i kalojë 6 (gjashtë) muaj nga fundi i secilës periudhë.

Nëse Kontraktori, në përputhje me parashikimet e paragrafëve 4.1.2 dhe 4.1.3 nuk vendos të hyjë në periudhën e dytë të kërkimit ose periudhën e tretë të kërkimit, Kontraktori do të lirohet nga çdo detyrim pune dhe shpenzimesh në lidhje me çdo periudhë të tillë në të cilën nuk është hyrë, por Kontraktori do të ketë të drejtën të vazhdojë me vlerësimin e çdo zbulimi komercial potencial që rezulton nga çdo pus i shpuar gjatë periudhës.

4.4 Gjithë pusët, për të cilët Kontraktori detyrohet sipas këtij neni IV, do të programohen drejt një objekti të besueshëm dhe të shpuar me profesionalizëm në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare të industrisë hidrokarbure.

4.5 Të paktën 3 (tre) muaj para fillimit të çdo viti kalendarik ose në kohë tjetër, siç mund të bihet dakord reciprokisht nga AKBN-ja dhe Kontraktori, Kontraktori do të përgatitë një program pune kërkimi dhe buxhetin përkatës për zonën e Kontratës, duke përcaktuar operacionet e kërkimit të cilat Kontraktori planifikon t'i kryejë gjatë vitit pasardhës kalendarik.

Gjatë periudhës së kërkimit, këto programe pune dhe buxhete do të jenë të paktën të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet minimale të punës së Kontraktorit për periudhën që mbulojnë.

4.6 Programi i punës dhe buxheti i kërkimit dhe çdo plan vlerësimi dhe plan zhvillimi do të shqyrtohen nga një komitet i përbashkët që do të ngrihet nga AKBN-ja dhe Kontraktori pas datës efektive të kësaj Kontrate. Ky komitet, këtu më pas i referuar si Komiteti Këshillimor i Kërkimit do të përbëhet prej 6 (gjashtë) anëtarësh, 3 (tre) prej të cilëve do të caktohen nga AKBN-ja dhe 3 (tre) nga Kontraktori. Kryetari i Komitetit Këshillimor të Kërkimit do të caktohet prej AKBN-së nga njëri prej anëtarëve të caktuar prej saj. Komiteti Këshillimor i Kërkimit do të ngrihet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data efektive. Komiteti Këshillimor i Kërkimit do të mblidhet të paktën dy herë në çdo vit kalendarik nëse nuk bihet dakord ndryshe nga operatori dhe AKBN-ja, dhe do të ketë funksionet dhe përgjegjësitë e mëposhtme, sipas kësaj Kontrate: a) të sigurojë mundësinë dhe të inkurajojë shkëmbimin e informacionit, ideve dhe sugjerimeve në lidhje me programin e punës



dhe buxhetin e kërkit të propozuar dhe rezultatet e operacioneve të kërkit; b) në rastin e një zbulimi të rishikojë propozimin e kontraktorit për vlerësimin dhe zhvillimin e mundshëm të këtij zbulimi; dhe c) të forcojë bashkëpunimin ndërmjet AKBN-së dhe Kontraktorit në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate në përputhje me termat e saj.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për kryerjen e të gjitha organizimeve për zhvillimin e mbledhjeve të Komitetit Këshillimor të Kërkit. Kostoja e arsyeshme dhe e nevojshme e zhvillimit të mbledhjeve të Komitetit Këshillimor të Kërkit (duke përfshirë, por pa u kufizuar, koston e arsyeshme dhe të nevojshme të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të autorizuar të AKBN-së në këto mbledhje) do të mbulohen dhe do të paguhen nga Kontraktori në emër të AKBN-së, si pjesë e kostonë së mbulueshme të shpenzimeve të kërkit të Kontraktorit, sipas kësaj Kontrate.

Në vazhdim të rishikimit të Komitetit Këshillimor të Kërkit, Kontraktori mund të bëjë ndryshimet e duhura dhe të dorëzojë në AKBN, programin e punës dhe buxhetin e kërkit, siç mund të jetë rishikuar.

Gjithashtu, Komiteti Këshillimor i Kërkit do të kontrollojë të gjitha operacionet e kërkit.

4.7 Më tej bihet dakord që:

4.7.1 Kontraktori mund të rishikojë apo modifikojë programin e punës dhe buxhetin në fjalë, siç mund të kërkohej për arsye operationale ose si rezultat i aktiviteteve të kërkit. Këto programe pune dhe buxhete të rishikuara do t'i nënshtrohen procedurës së përcaktuar në paragrafin 4.6.

4.7.2 Në rast të emergjencave që përfshijnë rrezik apo humbje të jetëve apo pronave apo ndotje të mjedisit, Kontraktori mund të shpenzojë ato sasi shtesë të paparashikuara në buxhet, siç mund të kërkohej për të zbutur këtë rrezik dhe do të informojë AKBN-në për rrethanat. Këto shpenzime, pas miratimit nga AKBN-ja, do të konsiderohen, si shpenzime kërkit dhe do të mbulohen në përputhje me nenin VII këtu, vetëm në rastet kur Kontraktori vërteton se këto situata emergjente nuk janë shkaktuar për faj të tij.

4.8 Kontraktori do t'i japë AKBN-së, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fundi i çdo tremujori kalendarik, një situacion të aktivitetit të kërkit, që tregon shpenzimet e kërkit të bëra dhe të

realizuara nga Kontraktori gjatë atij tremujori kalendarik. Regjistrat dhe dokumentet mbështetëse të Kontraktorit do të vihen në dispozicion për inspektim nga AKBN-ja në çdo kohë gjatë orarit zyrtar të punës për 3 (tre) muaj nga data e marrjes së çdo situacioni.

Brenda 3 (tre) muajsh nga data e marrjes së një situacioni të tillë, AKBN do të njoftojë Kontraktorin, me shkrim, me arsyet e nevojshme mbështetëse, nëse ajo konsideron që:

4.8.1 Regjistrimi i kostove nuk është i saktë;

4.8.2 Kostot e mallrave apo shërbimeve të kryera nuk janë në përputhje me çmimet ndërkombëtare të tregut për mallra apo shërbime të cilësisë së ngjashme të kryera me terma të ngjashëm që mbizotërojnë në kohën që këto mallra apo shërbime u porositen;

4.8.3 Gjendja e materialeve të furnizuara nga Kontraktori nuk përputhet me çmimet e tyre.

4.9 Kontraktori do të diskutojë me AKBN-në në lidhje me kundërshtimet e bëra sipas paragrafit 4.8, dhe Palët do të përpiqen të arrijnë brenda një periudhe 3-mujore (tremujore) një zgjidhje që është reciprokisht e kënaqshme. Nëse, brenda një periudhe 3-mujore (tremujore), të specifikuar në paragrafin 4.8 më sipër, AKBN-ja nuk ka kundërshtuar ndonjë zë në situacion, ky situacion do të konsiderohet i miratuar. Çdo zë që nuk kundërshtohet brenda 3 (tre) muajve në fjalë, do të konsiderohet i miratuar.

4.10 Ato kosto të cilat AKBN-ja i ka kundërshtuar siç parashikohet në paragrafin 4.8 (kosto të pezulluara) do të përfshihen në situacionin e mbulimit të kostonë dhe do të jenë kosto e mbulueshme, në pritje të zgjidhjes ose derisa të zgjidhet çështja sipas dispozitave të arbitrazhit të nenit XXI të kësaj Kontrate.

Kostot e pezulluara për të cilat është rënë dakord më pas nga AKBN-ja dhe Kontraktori (ose janë vendosur nga arbitrazhi, sipas nenit XXI këtu) të përjashtohen nga mbulimi i kostonë sipas kësaj Kontrate (kosto të refuzuara), do të paguhen tërësisht nga Kontraktori dhe nuk do të jenë kosto të mbulueshme.

Çdo rimbursim që i takon AKBN-së nga hidrokarburet për mbulim kostoje, si rezultat i një vendimi të marrë nga arbitrat ose nga zgjidhja pas revizionit, do t'i bëhet AKBN-së në para, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e marrjes së vendimit apo arritjes së zgjidhjes.



4.11 Në datën efektive ose sa më shpejt që të jetë e mundur pas saj, AKBN-ja do të vërë në dispozicion për përdorim nga Kontraktori, kopje të të gjitha të dhënave sizmike dhe të dhëna të tjera të kërkitimit në zotërim nga AKBN-ja në lidhje me zonën e Kontratës, pa kosto për Kontraktorin, duke përjashtuar kostot nominale të grumbullimit, përgatitjes dhe riprodhimit dhe më pas do t'i japë në kohë Kontraktorit çdo të dhënë tjetër, siç dhe kur sigurohet nga AKBN-ja. Këto të dhëna do t'u nënshtrohen klauzolave të konfidencialitetit nga Kontraktori njësoj siç përcaktohen në nenin 15.5.

4.12 Operatori

4.12.1 Kontraktori do të zgjedhë një nga njësitë që përbëjnë Kontraktorin që të veprojnë si operator, i cili do të kryejë operacionet hidrokarbure në zonën e Kontratës, në përputhje me legjislacionin shqiptar të zbatueshëm, termat dhe kushtet e kësaj Kontrate dhe me praktikat e mira ndërkombëtare të hidrokarbureve.

4.12.2 Albanides Energy sh.p.k. emërohet këtu si operator, që nga data efektive.

4.12.3 Emërimi i një pasuesi të operatorit do të jetë subjekt i një miratimi paraprak nga AKBN-ja, me kushtin që një aprovim i tillë nuk kërkohet dhe do të jepet vetëm njoftim me shkrim, në qoftë se pasardhësi i operatorit, është një filial i kompanisë.

Neni V Heqja dorë

5.1 Heqja dorë e detyruar

5.1.1 Nëse Kontraktori hyn në periudhën e dytë të kërkitimit ose periudhën e tretë të kërkitimit, brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh pas fundit të periudhës së mëparshme të kërkitimit, Kontraktori do t'i dorëzojë AKBN-së 25% (njëzet e pesë) për qind të zonës së Kontratës minus ndonjë pjesë të zonës së Kontratës nga e cila është hequr dorë më parë, sipas nenit 5.1.3 të kësaj Kontrate.

5.1.2 Me mbarimin e periudhës së kërkitimit, Kontraktori do t'i dorëzojë AKBN-së gjithë pjesën e mbetur të zonës së Kontratës që nuk është pjesë e një zone zbulimi apo një zone zhvillimi dhe prodhimi.

5.1.3 Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Kontrate, Kontraktorit nuk do t'i kërkohet të heqë dorë nga zona që përfshihen në një zonë zbulimi apo në një zonë zhvillimi dhe prodhimi.

5.2 Kontraktori mundet vullnetarisht, në çdo

kohë, të heqë dorë nga gjithë apo pjesë të zonës së Kontratës; me kusht që, në kohën e një heqjeje dorë të tillë të vullnetshme, detyrimet e tij të kërkitimit për atë periudhë aktuale të jenë përmbushur.

Çdo heqjeje dorë e tillë vullnetare, sipas gjykimit të Kontraktorit, do të kreditohet ndaj heqjeve dorë të mëvonshme të detyrueshme.

5.3 Zonat nga të cilat Kontraktori ka hequr dorë sipas këtij neni V, do t'i kalojnë automatikisht AKBN-së dhe mund të përdoren lirshëm apo jepen nga AKBN-ja. Megjithatë, Kontraktori mund të vazhdojë të përdorë ato objekte dhe instalime operuese që ai ka ndërtuar apo është duke ndërtuar në ato zona për qëllime të kësaj Kontrate.

5.4 Zonat nga të cilat Kontraktori ka hequr dorë sipas këtij neni V, do të jenë të dimensioneve dhe formave të mjaftueshme në mënyrë të arsyeshme për të mundësuar kryerjen e operacioneve hidrokarbure në to nga AKBN-ja ose palët e treta, me kusht që kjo të mos ndërhyjë në operacionet e Kontraktorit sipas kësaj Kontrate.

5.5 Çdo heqje dorë sipas këtij neni V do të jetë e përjashtuar nga taksat apo tatimet mbi të ardhurat, transferimet apo taksa të lidhura me to.

5.6 Përpara se të hiqet dorë nga ndonjë pjesë e zonës së Kontratës në të cilën janë kryer operacione hidrokarbure, Kontraktori do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të eliminuar çdo impakt negativ të konsiderueshëm ndaj ambientit të shkaktuar nga operacionet hidrokarbure, të gjitha këto në masën e nevojshme sipas kërkesave ligjore në fuqi në datën efektive dhe të abandonojë zonën e Kontratës në përputhje me një plan abandonimi të paraqitur dhe të miratuar nga AKBN-ja, aprovim i cili nuk do të refuzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

5.7 Në datën në të cilën duhet bërë heqja dorë ose kur ajo duhet të hyjë në fuqi ose në përfundimin e kësaj Kontrate, Kontraktori nuk do të ketë më tej të drejta ose detyrime në lidhje me zonat nga të cilat hiqet dorë; megjithatë çdo përgjegjësi që i caktohet këtu Kontraktorit përpara kësaj date, do të vazhdojë të mbesë në fuqi, nga data e përfundimit të Kontratës, deri sa AKBN-ja të çlirojë me shkrim Kontraktorin, çlirim i cili nuk do të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

5.8 Asnjë heqje dorë nuk do ta çlirojë Kontraktorin nga detyrimet minimale të papër-



mbushura sipas nenit IV dhe/ose çdo detyrim tjetër i akumuluar përpara kësaj heqjeje dorë.

Neni VI

Operacionet pas zbulimit

6.1 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi është përcaktuar prej Kontraktorit një datë zbulimi, Kontraktori do të njoftojë AKBN-në, me shkrim, për zbulimin dhe do t'i japë AKBN-së rezultatet e testimit. Në vijim të një zbulimi, Kontraktori mund të prodhojë, transportojë dhe shesë hidrokarburet e prodhuara nga testimi, siç mund të lejohet nga AKBN-ja. Ky prodhim është subjekt i nenit VII.

6.2 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas njoftimit të zbulimit sipas paragrafit 6.1, Kontraktori do të njoftojë me shkrim AKBN-në nëse Kontraktori e konsideron zbulimin që ia vlen të vlerësohet si zbulim komercial i mundshëm.

6.3 Në rast se Kontraktori njofton AKBN-në, sipas paragrafit 6.2, që ai e konsideron një zbulim që ia vlen të vlerësohet si një zbulim komercial i mundshëm, Kontraktori do të njoftojë menjëherë pas kësaj AKBN-në për planet e tij të vlerësimit për zbulimin në fjalë dhe do të ndërmarrë vlerësimin e zbulimit, duke kryer punime të tilla që, sipas mendimit të kontraktorit, mund të jenë të nevojshme të përcaktojnë nëse një zbulim i tillë ia vlen të zhvillohet në mënyrë komerciale, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët teknikë dhe ekonomikë.

Periodha e vlerësimit për një zonë zbulimi do të jetë 3 (tre) vite për naftën bruto dhe 5 (pesë) vite për gazin natyror apo naftës bruto me gaz shoqërues.

Në rastin e gazit natyror apo naftës bruto me gaz shoqërues një periudhë vlerësimi mund të shtyhet deri në 5 (pesë) vjet, duke dëshmuar se Kontraktori ka bërë gjithë përpjekjet në kërkimin e zgjidhjeve më të mira për këtë çështje.

AKBN-ja nuk do të kundërshtojë aprovimin e saj në mënyrë të paarsyeshme.

Gjatë periudhës së vlerësimit Kontraktori do të shohë dhe do të vlerësojë mundësi të ndryshme për zhvillim dhe shfrytëzim ekonomik të këtyre zbulimeve.

6.4 Brenda 6 (gjashtë) muajsh pas përfundimit të vlerësimit, Kontraktori do të:

6.4.1 dorëzojë në AKBN një plan zhvillimi për qëllim të deklarimit të një zbulimi komercial; ose

6.4.2 njoftojë AKBN-në që zbulimi mund të jetë komercial nëse bëhen zbulime të tjera dhe zhvillohen e shfrytëzohen bashkërisht me të ose që Kontraktori propozon të bëjë punime shtesë në zonën e Kontratës për atë qëllim; ose

6.4.3 Njoftojë AKBN-në që Kontraktori nuk e konsideron zbulimin si komercial të mundshëm.

6.5 Një plan zhvillimi, i dorëzuar në përputhje me paragrafin 6.4.1 më sipër dhe i paraqitur në Komitetin Këshillimor të Kërkimit, do t'i nënshtrohet miratimit të AKBN-së, miratim i cili nuk do të mbahet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme dhe do të jepet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga marrja e planit të zhvillimit ose ndryshe do të konsiderohet të jetë miratuar. Kontraktori do të vazhdojë më pas të zhvillojë zbulimin në përputhje me planin e zhvillimit të miratuar.

6.6 Në rast të një njoftimi nga Kontraktori sipas paragrafit 6.4.2 më sipër, Kontraktori do të paraqesë në Komitetin Këshillimor të Kërkimit dhe do t'i dorëzojë AKBN-së me shkrim për miratim, miratim i cili nuk do të mbahet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme, një plan që përmban një përshkrim të punimeve shtesë që Kontraktori i konsideron të nevojshme dhe grafikun e parashikuar për punimet në fjalë, në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare të hidrokarbureve. Kontraktori do të ndërmarrë, si pjesë e programit të tij të kërkimit, kryerjen e punimeve shtesë në fjalë në përputhje me planin dhe grafikun e dorëzuar tek AKBN-ja.

6.7 Në rast të një njoftimi nga Kontraktori sipas paragrafit 6.4.3 më sipër, AKBN-ja do të ketë të drejtën të zhvillojë dhe të shfrytëzojë zbulimin për përfitimin e vetëm të saj dhe me koston dhe riskun e vetëm të saj, dhe Kontraktori nuk do të ketë asnjë të drejtë në një zbulim të tillë dhe do të dorëzojë, në përputhje me Kontratën, legjislacioni shqiptar të zbatueshëm dhe praktikën e mira ndërkombëtare të hidrokarbureve, zonën e Kontratës; megjithatë, të drejtat e Kontraktorit në pjesën që mbetet të zonës së Kontratës, nuk do të ndikohen si pasojë e kësaj.

6.8 Çdo zbulim komercial mund të konsistojë në 1 (një) rezervuar apo një grup rezervuarësh, të cilët, pas vlerësimit konsiderohen nga Kontraktori se ia vlen të zhvillohen në mënyrë komerciale.

6.9 Brenda 3 (tre) muajsh pas dorëzimit, sipas paragrafit 6.4.1 të kësaj Kontrate, Kontraktori do t'i japë AKBN-së një raport mbi faktorët teknikë dhe



ekonomikë të konsideruar në përcaktimin që zbulimi ia vlen të zhvillohet në mënyrë komerciale.

6.10 Periudha e prodhimit do të jetë 20 (njëzet) vjet nga data e prodhimit fillestar komercial për secilin vendburim dhe, bazuar në ligjin “Për hidrokarburet”, mund të zgjatet, me zgjedhjen e Kontraktorëve, me 5 (pesë) vjet shtesë, që i nënshtrohet miratimit nga AKBN-ja, miratim i cili nuk do të pengohet në mënyrë të paarsyeshme.

6.11 Kontraktori do të përgatitë një program pune dhe buxhet zhvillimi për pjesën e mbetur të vitit kalendarik në të cilin Kontraktori bën një deklaram në përputhje me paragrafin 6.4.1 të kësaj Kontrate, dhe do t’ia dorëzojë atë AKBN-së për miratim, jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së dorëzimit të një deklarimi të tillë. Në ose para datës së 15 (pesëmbëdhjetë) të tetorit të çdo viti kalendarik pas asaj, Kontraktori do të përgatitë dhe do të dorëzojë tek AKBN-ja për miratim një program pune dhe buxhet zhvillimi për vitin kalendarik pasardhës. Miratimi nga AKBN-ja nuk do të pengohet në mënyrë të paarsyeshme dhe do të jepet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e secilit program pune dhe buxhet zhvillimi, në mungesë të të cilit miratimi do të konsiderohet të jetë dhënë. Kontraktori do t’i dorëzojë, gjithashtu, AKBN-së një grafik vjetor prodhimi bazuar në dispozitat e paragrafit 7.15.

6.12 Kontraktori do të regjistrojë të dhënat që lidhen me sasi të hidrokarbureve të disponueshme, ujit dhe materialeve të tjera të prodhuara çdo muaj kalendarik sipas kësaj Kontrate, duke treguar pjesën e hidrokarbureve fitim që i përket secilës Palë sipas kësaj Kontrate. Këto të dhëna do t’i dorëzohen AKBN-së dhe autoriteteve tatimore përkatëse shqiptare në bazë mujore. Statistika ditore apo javore në lidhje me prodhimin nga zona e Kontratës, do të jenë të disponueshme në çdo kohë të arsyeshme për ekzaminim nga përfaqësues të autorizuar të AKBN-së.

6.13 Kontraktori, do t’i japë AKBN-së, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga fundi i çdo tremujori kalendarik, një situacion të aktivitetit të zhvillimit që reflekton gjithë debitimet dhe kreditimet që lidhen me zhvillimin dhe prodhimin për atë tremujor kalendarik (“Shpenzime zhvillimi” dhe “Shpenzime operative”) të përmbledhura në klasifikimet e duhura që tregojnë natyrën e tyre. Ky situacion do t’i nënshtrohet revizionit nga AKBN-

ja, siç parashikohet në paragrafin 4.2, të nenit I të procedurës së kontabilitetit.

6.14 Nëse del e arsyeshme nga rishikimet e të dhënave teknike që një zonë zbulimi apo zonë zhvillimi e prodhimi mund të shtrihet jashtë zonës së Kontratës, Palët do të takohen të diskutojnë bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe/ose me çdo palë të tretë që mund të përfshihet në shtrirjen e kërkimit, zhvillimit ose prodhimit jashtë zonës së Kontratës, por këto diskutime nuk do të interferojnë me vazhdimin e vlerësimit, zhvillimit dhe prodhimit të hidrokarbureve nga ana e Kontraktorit nga pjesa e rezervuarit që ndodhet në zonën e Kontratës.

6.14.1 Nëse provohet nga shpimi jashtë zonës së Kontratës që shtresa hidrokarburmbajtëse në zonën e Kontratës shtrihet në një zonë tjetër apo zona të tjera, në lidhje me të cilat një Kontratë tjetër apo licencë është në fuqi apo është dhënë nga AKBN-ja dhe standardet dhe praktikatat e njohura të industrisë hidrokarbure kërkojnë si domosdoshmëri që gjithë vendburimi duhet të përpunohet dhe zhvillohet si një njësi, Kontraktori do të përpiqet të bashkëpunojë me licencëmbajtësit në blloqet fqinje, në mënyrë që të arrihet një zgjidhje optimale teknike dhe ekonomike për zhvillimin e të gjithë vendburimit. Në qoftë se Kontraktori dhe mbajtësit e tjerë të licencave në blloqet fqinje respektive nuk mund të bien dakord për një skemë zhvillimi të përbashkët ose në qoftë se AKBN-ja e konsideron që skema e zhvillimit të përbashkët nuk është në interesin kombëtar, AKBN-ja mund të kërkojë që të gjitha operacionet duhet të kryhen në akordancë me një skemë të përbashkët zhvillimi.

6.14.2 Për skemën e zhvillimit të përbashkët do të bihet dakord mes Kontraktorit dhe palës së tretë që mban licencën e dhënë nga AKBN-ja, të cilat do ta paraqesin bashkërisht për miratim nga AKBN-ja. Dështimi në arritjen e një skeme zhvillimi të unitizuar mes Kontraktorit dhe palës së tretë ose dështimi në miratimin e tij nga AKBN-ja, skema e zhvillimit të unitizuar do të jetë skema e përgatitur nga një ekspert. Në qoftë se Kontraktori gjykon se skema e përgatitur nga eksperti është e papranueshme, Kontraktori do të ketë të drejtën të kërkojë modifikimin e saj ose të heqë dorë nga zona e zbulimit.

6.14.3 Nëse shtresa hidrokarburmbajtëse në zonën e Kontratës, e konsideruar nga Kontraktori



si një zonë zbulimi e vetme apo zonë zhvillimi dhe prodhimi, shtrihet në një zonë apo zona të tjera mbi të cilat qeveria shqiptare ka juridiksion dhe në lidhje me të cilat asnjë kontratë apo licencë nuk është në fuqi as nuk është subjekt i një dhënie të drejtash nga AKBN-ja, atëherë AKBN-ja dhe Kontraktori do të bëjnë përpjekjet më të mira të tyre për të negociuar një marrëveshje për të zmadhuar zonën e Kontratës, përkatësisht dhe për të bërë atë që është e nevojshme për një vlerësim dhe zhvillim të duhur të zbulimit. Kjo marrëveshje do të përfshijë dispozita që kjo Kontratë do të zbatohet për zonën e zmadhuar. Kontraktori do të lejohet të kryejë një vlerësim të tillë në zonën në fjalë, siç mund të kërkohet për të përcaktuar zonën për t'u zmadhuar. Para fillimit të diskutimeve mbi një marrëveshje të tillë, Kontraktori do të lejohet të rishikojë çdo të dhënë teknike në lidhje me zonën, që janë në dispozicion të çdo agjencie të qeverisë shqiptare.

6.14.4 Në rast se shtresa hidrokarburmbajtëse e referuar në paragrafin 6.14 shtrihet në një zonë që nuk përbën pjesë të një zonë Kontrate dhe mbi të cilën Republika e Shqipërisë nuk ka juridiksion, operacionet hidrokarbure të Kontraktorit do të kryhen në përputhje me ato detyrime ndërkombëtare të Shqipërisë, siç mund të jenë të aplikueshme dhe AKBN-ja do të ndërmarrë negociime me agjencinë kompetente të qeverisë së huaj që ka juridiksionin, për të rënë dakord për një skemë zhvillimi të unitizuar, duke pasur ndër mend interesat e Kontraktorit. Kjo Kontratë do të amendohet për të reflektuar marrëveshjen e arritur ndërmjet dy vendeve. Në qoftë se një marrëveshje e tillë është e papranueshme për Kontraktorin, atëherë Kontraktori do të ketë të drejtën të kërkojë modifikimin në përputhje me këtë ose të heqë dorë nga zona e zbulimit në të cilën ndodhet shtresa hidrokarburmbajtëse.

6.15 Kontraktori mund të përdorë lirshëm për operacionet hidrokarbure këtu, hidrokarburet e prodhuara nga zona e Kontratës, në përputhje me legjislacionin shqiptar të zbatueshëm, me termat dhe kushtet e kësaj Kontrate dhe me praktikat e mira ndërkombëtare të hidrokarbureve.

6.16 Gazi shoqëruar natyror nga zona e Kontratës, i papërdorur nga Kontraktori për operacionet hidrokarbure dhe që nuk i nënshtrohet nenit VIII të kësaj Kontrate, mund të digjet apo rinjektohet sipas zgjedhjes së Kontrak-

torit, nëse AKBN-ja nuk i kërkon Kontraktorit, me shkrim, t'ia livrojë gazin shoqëruar natyror në fjalë AKBN-ja në separatorët e vendburimit. Ky livrim ndaj AKBN-së nuk do të interferojë në operacionet hidrokarbure normale të Kontraktorit dhe në grafikun për zhvillim. Çdo kosto që lidhet me përmbushjen nga ana e Kontraktorit të kërkesës së AKBN-ja do të mbulohet nga AKBN-ja.

Neni VII

Mbulimi i kostove dhe shpenzimeve, ndarja e prodhimit, hidrokarburet fitim dhe kostot e pambulueshme

Hidrokarbure për mbulim kostoje

7.1 Kontraktori do të mbulojë të gjitha kostot dhe shpenzimet sipas kësaj Kontrate nga pjesa e hidrokarbureve të disponueshme, e cila, sipas aplikimit këtu quhet "Hidrokarburet për mbulimin e kostos, nafta bruto për mbulimin e kostos, gazi për mbulimin e kostos". Pjesa e hidrokarbureve të disponueshme që do të përcaktohen si hidrokarbure për mbulim kostoje, është njëqind për qind (100%) e hidrokarbureve të disponueshme, pas heqjes së rentës minerare. Kontraktori ka të drejtë t'i marrë hidrokarburet për mbulimin e kostos në natyrë, t'i eksportojë lirisht dhe t'i përdorë ato.

Kostot dhe shpenzimet e rikuperueshme në çdo muaj kalendarik do të rikuperohen së pari nga nafta bruto për mbulimin e kostos, në qoftë se ka të tillë dhe së dyti nga gazi për mbulimin e kostos, në qoftë se ka të tillë.

7.2 Kostot dhe shpenzimet sipas kësaj Kontrate do të mbulohen nga hidrokarburet për mbulim kostoje në mënyrën e mëposhtme:

7.2.1 Shpenzimet e kërkimit, duke përfshirë totalin e atyre të akumuluar para datës së prodhimit fillestar komercial, do të mbulohen plotësisht, pa amortizim, duke filluar në: i) muajin kalendarik në të cilin janë kryer këto shpenzime; ose ii) muajin kalendarik në të cilin bie data e prodhimit fillestar komercial ose testit, ose prodhimit të zgjeruar, cilido muaj vjen më pas.

7.2.2 Shpenzimet e zhvillimit, duke përfshirë ato të akumuluar para datës së prodhimit fillestar komercial do të jenë plotësisht të mbulueshme, pa amortizim, duke filluar në: i) muajin kalendarik në të cilin janë kryer këto shpenzime; ose ii) muajin kalendarik në të cilin bie data e prodhimit fillestar komercial, cilido muaj vjen më pas. Shpenzimet e



zhvillimit duhet të jenë të arsyeshme, domethënë, në përputhje me praktikat e industrisë ndërkombëtare të hidrokarbureve dhe çmimeve të tregut për shërbimet, pajisjet dhe materialet e të njëjtit lloj dhe cilësi, të disponueshme në kohën që kërkohen sipas kësaj Kontrate.

7.2.3 Gjithë shpenzimet operative të bëra pas datës së zbulimit komercial do të jenë të mbulueshme plotësisht, pa amortizim, duke filluar në: i) muajin kalendarik në të cilin janë kryer këto shpenzime; ose ii) muajin kalendarik në të cilin ndodh data e prodhimit fillestar komercial, cilido muaj vjen më pas. Shpenzimet operative duhet të jenë të arsyeshme, domethënë, në përputhje me praktikat e industrisë ndërkombëtare të hidrokarbureve dhe çmimeve të tregut për shërbimet, pajisjet dhe materialet e të njëjtit lloj dhe cilësi, të disponueshme në kohën që kërkohen sipas kësaj Kontrate.

7.3 Në atë masë që, për çdo tremujor kalendarik, situacioni i mbulimit të kostos tregon kosto dhe shpenzime të pambuluara, këto sasi të pambuluara do të mbarten në situacionet në fjalë për mbulim në tremujorin apo tremujorët e tjerë kalendarikë pasardhës derisa të mbulohen plotësisht.

7.4 Njëkohësisht, me aprovimin e planit të zhvillimit, AKBN-ja dhe Kontraktori do të bien dakord nëse pjesa e hidrokarbureve fitim e AKBN-së dhe granti për qeverinë do të merret nga AKBN-ja në hidrokarbure apo do të merret dhe shitet nga Kontraktori në emër të AKBN-së dhe në vazhdim, pasi të merren të ardhurat nga një shitje e tillë, t'i paguhet AKBN-ja në para, bazuar në vlerësimin e hidrokarbureve sipas nenit VII.

Në rast se Palët bien dakord që granti për qeverinë dhe/ose pjesa e hidrokarbureve fitim e AKBN-së do të merret nga AKBN-ja në natyrë, marrëveshja *inter alias* do të përmbajë parashikime në lidhje me alokimin e sasive të ndryshme të hidrokarbureve dhe procedurat për marrjen, duke përfshirë marrjen e tepërt ose të mangët të pjesës së AKBN-së.

7.5 Çdo muaj kalendarik, Kontraktori do të marrë në natyrë në pikën e matjes dhe do të disponojnë hidrokarburet për mbulim kostoje, plus pjesën e tyre të hidrokarbureve fitim në përputhje me paragrafin 7.6. Me dorëzimin tek AKBN-ja të çdo situacioni tremujor të mbulimit të kostos, Palët

do të bëjnë rregullimet e duhura në përputhje me paragrafët 7.3 dhe 7.4.

Ndarja e hidrokarbureve fitim - Faktori R

7.6 Në lidhje me çdo muaj kalendarik, të gjitha hidrokarburet e disponueshme të mbetura pas zbritjes së rentës minerare, grantit për qeverinë dhe të gjitha shpenzimeve dhe kostove të mbulueshme, sipas kësaj Kontrate për atë muaj kalendarik, do të jenë hidrokarbure fitim dhe në përputhje me paragrafin 7.5 më sipër, do të merren në natyrë në pikën e matjes dhe do të disponohen lirshëm dhe veçmas nëpërmjet eksportimit apo në mënyra të tjera, me riskun, koston dhe shpenzimet përkatëse të tyre nga AKBN-ja dhe Kontraktori, siç është e aplikueshme. Pjesa përkatëse apo përqindja e hidrokarbureve fitim ndaj të cilave kanë të drejtë AKBN-ja dhe Kontraktori gjatë një muaji kalendarik, përcaktohet siç parashikohet në këtë paragraf 7.6.

7.6.1 Faktori R do të përdoret për qëllim të përcaktimit të titullimit përkatës të Palëve ndaj hidrokarburet fitim dhe grantit për qeverinë në çdo muaj kalendarik. Faktori R do të thotë dhe do të llogaritet si raporti i të ardhurave kumulative të Kontraktorit nga data efektive deri në fund të vitit paraardhës kalendarik ndaj shpenzimeve kumulative të Kontraktorit të realizuara nga data efektive deri në fund të vitit paraardhës kalendarik.

Të ardhurat kumulative do të jenë vlera totale, e përcaktuar në përputhje me nenin VII dhe aneksin D, e: a) pjesës së hidrokarbureve fitim të kontraktorit; plus b) hidrokarburet për mbulim kostoje; minus të gjitha taksat shqiptare të Kontraktorit siç janë paguar.

Të ardhurat kumulative në fjalë do të përshtaten me një faktor inflacioni bazuar në indeksin e çmimeve të konsumatorit të botuar nga departamenti i punës i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe llogaritur mbi bazë vjetore.

Shpenzimet kumulative do të jenë vlera totale e të gjitha kostove, shpenzimeve dhe harxhimeve të realizuara më parë nga Kontraktori sipas Kontratës, si shpenzime zhvillimi, shpenzime kërkimi apo shpenzime operative, apo si pagesa të bëra sipas nenit XXVII.

Shpenzimet kumulative në fjalë do të përshtaten me një faktor inflacioni bazuar në indeksin e çmimeve të konsumatorit të botuar nga departamenti i punës i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe llogaritur mbi bazë mujore.



7.6.2 Në vartësi të dispozitave të tjera të kësaj Kontrate, përçindja e hidrokarbureve fitim që përbën pjesët përkatëse të AKBN-së dhe Kontraktorit përcaktohet për çdo muaj kalendarik duke përdorur faktorin R të aplikueshëm për atë vit

kalendarik (i llogaritur siç parashikohet në paragrafin 7.6.1). Pjesa e hidrokarbureve fitim e AKBN-së dhe Kontraktorit, tregohet në tabelën e mëposhtme:

Faktori R	Nafta bruto		Gaz	
	Albanides Energy	AKBN	Albanides Energy	AKBN
$0 < R \leq 1$	100 %	0 %	100%	0%
$1 < R \leq 2$	99%	1%	97.5%	2.5%
$2 < R \leq 3$	98%	2%	95 %	5%
$R > 3$	97%	3%	92.5%	7.5%

Pranohet që pjesa e hidrokarbureve fitim e kontraktorit, gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, do t'i nënshtrohet, një tatimi mbi fitimin në masën 50% për t'u paguar në përputhje me nenin XI të kësaj Kontrate. Në rast se zhvillimi i një zbulimi përcaktohet të jetë marginal nga pikëpamja ekonomike ose është bërë marginal si pasojë e shfrytëzimit të tij, dhe kërkohen lehtësira të tjera tatimore nga Kontraktori për të vazhduar me zhvillimin. Në rast se zhvillimi i një zbulimi përcaktohet të jetë marginal nga pikëpamja ekonomike ose është bërë marginal si pasojë e shfrytëzimit të tij, dhe kërkohen lehtësira të tjera tatimore nga Kontraktori për të vazhduar me zhvillimin, Kontraktori dhe AKBN-ja do të bëjnë përpjekjet më të mira për të siguruar lehtësimin nga tatimet.

7.7 Pavarësisht nga ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate që është e kundërt me këtë, prodhimi mesatar ditor nuk do të përcaktohet derisa të gjitha tubacionet apo pjesët e tyre, që kërkohen për marrjen e hidrokarbureve para apo pas pikës së matjes të jenë mbushur dhe presuar me sasinë e duhur të hidrokarbureve (*Line Fill*). AKBN-ja dhe Kontraktori do të bien dakord me shkrim për kohën kur mund të disponohet *Line Fill* dhe mund të përfshihet në prodhimin mesatar ditor.

7.8 Sipas kësaj Kontrate, shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të mbulueshme:

a) kostot e realizuara para datës efektive që lidhen me kryerjen e një detyrimi pune, të pamiratuara nga AKBN-ja;

b) kostot e realizuara përtej pikës së livrimit;

c) dhuratat apo kontributet e pamiratuara nga AKBN-ja;

d) çdo bonus prodhimi i paguar AKBN-së në përputhje me nenin XXVII;

e) gjolat e vëna në mënyrë të rregullt nga një agjenci e qeverisë shqiptare dhe të paguara nga Kontraktori;

f) shpenzimet për interesat të kryera nga Kontraktori në lidhje me huat bankare të marra për të financuar operacionet hidrokarbure.

Çmimi i naftës bruto

7.9 Vlera e naftës bruto e marrë në natyrë dhe e disponuar nga Kontraktori sipas kësaj Kontrate gjatë çdo muaji kalendarik, për të gjitha qëllimet sipas kësaj Kontrate, do të llogaritet mbi bazën e çmimit mesatar të ponderuar të marrë realisht në monedhë, lirisht të konvertueshme në pikën FOB të shitjes së eksportit të naftës bruto nga Shqipëria sipas kësaj Kontrate të ndërmarra nga Kontraktori. Për këtë qëllim, të gjitha kontratat e shitjes së naftës bruto në fuqi me shoqëri jofiliale do të merren në konsideratë, duke përjashtuar kontratat me klering, dhe çdo shitje të çastit që nuk është në mënyrë të arsyeshme konsistente me çmimet predominuese të tregut për naftë bruto. Kuptohet që, në rast të shitjeve CIF, do të bëhen zbritjet e duhura për pagesat e transportit dhe sigurimit, faktike apo të deklaruara, cilado që të jetë më e ulët, për të llogaritur çmimin FOB në pikën e eksportit. Në asnjë rast nuk do të zbritet ndonjë komision apo shpërblim për marketimin.

7.10 Për rastin në të cilin, gjatë një muaji kalendarik, nuk ka shitje për eksport nga Kontraktori, sipas kontratave të shitjeve të naftës bruto në fuqi, AKBN-ja dhe Kontraktori, para datës së prodhimit fillestar komercial, do të bien dakord për një shportë prej të paktën 2 (dy) dhe jo



më shumë se (katër) naftë bruto, të cituara për qëllime të vendosjes së çmimit dhe të disponueshme për eksport në portet e Mesdheut, që janë të krahasueshme me naftën bruto të disponueshme dhe që tregtohen lirshëm në tregjet ndërkombëtare (shporta). Vlera e naftës bruto për mbulim kostoje do të jetë çmimi mesatar i shportës për çdo muaj kalendarik në të cilin nuk janë bërë shitje për eksport siç përcaktohet nga çmimet e naftës bruto në shportë të botuara nga *Platt's Oilgram Price Report* për çmimet botërore të naftës bruto, kolona “Kontrata afatshkurtra/shitje të çastit” për transaksionet e përfunduara në atë muaj kalendarik. Kuptohet që parimet e mëposhtme do të zbatohen në lidhje me shportën:

7.10.1 Nafta bruto që do të përfshihet në shportë si e krahasueshme me naftën bruto të disponueshme do të jetë ajo që nuk do të ndryshojë me më shumë se 4 (katër) gradë API më shumë ose më pak se sa kjo naftë bruto, dhe përqindja e sqfurit e tyre nuk do të jetë më e lartë se një për qind (1%) mbi atë të kësaj naftë bruto.

7.10.2 Çmimi i shportës do të rregullohet si më poshtë: i) me një e gjysmë cent të SHBA-së (U.S.\$0.015) për fuçi për çdo një të dhjetë të plotë (1/10) të gradës API me të cilën nafta bruto është sipër ose nën mesataren aritmetike të gravitetit API të shportës; ii) me pesë cent të SHBA-së (U.S.\$0.05) për fuçi për çdo një të dhjetë të plotë të një për qind (0.1%) me të cilin përqindja e sqfurit në naftën bruto është sipër ose nën mesataren aritmetike të përqindjes së sqfurit të shportës; dhe iii) me diferencën ndërmjet tarifës së transportit për transportimin e naftës bruto nga pika e eksportit në Lavera, Francë, dhe mesataren aritmetike të tarifës së transportit për shportën për transportin e naftës bruto në shportë nga pika e zakonshme FOB e origjinës së tyre në Lavera, Francë. Nëse mesatarja aritmetike e tarifës së transportit të shportës është më e lartë, kjo diferencë i shtohet çmimit të shportës. Nëse mesatarja aritmetike e tarifës së transportit të shportës është më e ulët, kjo diferencë do të zbritet nga çmimi i shportës. Për këtë qëllim, “tarifa e transportit” do të përcaktohet si “vlerësimi mesatar i përqindjes së transportit” (AFRA) kuotim tarife për anije të përmasave LR2, siç botohet për atë muaj kalendarik, e shumëzuar me: a) përqindjen e aplikueshme në shkallë botërore për transportin e naftës bruto nga pika e eksportit në Lavera, Francë; dhe b) mesataren

aritmetike të përqindjes së aplikueshme në shkallë botërore për naftë bruto në shportë nga pika e zakonshme e eksportit të tyre FOB në Lavera, Francë.

7.10.3 Nëse botimi në fjalë apo ndonjë botim i përshtatshëm pasues nuk do të botohet më, AKBN-ja dhe Kontraktori duhet të bien dakord me shkrim për një botim zëvendësues. Në rast se nuk ka botim që mund të përdoret si bazë, Palët do të bien dakord me shkrim për procedurën që do të ndiqet për të fiksuar shportën.

7.10.4 Në rast se, në të ardhmen, çmimi i një apo më shumë naftë bruto që përbëjnë shportën citohet në një monedhë të ndryshme nga dollari, çmimi në fjalë do të konvertohet në dollarë me kursin mesatar të blerjes, të kurseve të këmbimit për atë monedhë të cituar nga Citibank, Londër, në momentin e mbylljes së biznesit në çdo ditë përkatëse.

7.10.5 Shporta mund të rishikohet në mënyrë periodike, nëse kërkohet, me marrëveshje me shkrim ndërmjet AKBN-së dhe Kontraktorit për të reflektuar çdo ndryshim në cilësinë e naftës bruto të prodhuar nga zona e kontratës.

7.10.6 Në mungesë të një citimi të 1 (një) ose më shumë prej naftë të rënë dakord në shportë, AKBN-ja dhe Kontraktori do të takohen për të rënë dakord mbi zëvendësimin e naftës bruto.

7.11 Në rast se AKBN-ja dhe Kontraktori nuk kanë qenë në gjendje të përcaktojnë shportën për qëllime të paragrafit 7.12 brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas fundit të muajit kalendarik përkatës, secili, brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas asaj, do të caktojë një ekspert për vendosjen e çmimit të naftës bruto. Këta 2 (dy) ekspertë, brenda një 30-ditëshi (tridhjetëditëshi) tjetër pasi të jenë konsultuar me palët kontraktuese do të bien dakord për një ekspert të tretë në vendosjen e çmimit të naftës bruto, prej nga këta 3 (tre) ekspertë, sa më shpejt që të jetë e mundur, do të përpiqen të përcaktojnë shportën në përputhje me parimet e përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 7.12 më sipër. Nëse AKBN-ja apo Kontraktori dështojnë në caktimin e ekspertit si më sipër, Pala tjetër do të ketë të drejtën t'i drejtohet Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, Francë, të caktojë një ekspert që të veprojë për Palën e dështuar.

Nëse këta dy (2) ekspertë nuk do të jenë në gjendje të bien dakord për një të tretë, një ekspert neutral do të caktohet, gjithashtu, nga Dhoma



Ndërkombëtare e Tregtisë në Paris, Francë. Përcaktimi i shportës do të bëhet jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas caktimit të ekspertit të tretë. Përcaktimi nga të tre ekspertët e caktuar do të bëhet me shumicë votash dhe do të jetë detyrues dhe përfundimtar për AKBN-në dhe Kontraktorin. Kostot dhe shpenzimet e ekspertëve do të ngarkohen në mënyrë të barabartë për AKBN-në dhe Kontraktorin.

7.12 Në pritisje të marrëveshjes së përbashkët sipas paragrafit 7.12 apo përcaktimit të ekspertëve sipas paragrafit 7.13, do të përdoret një shportë që të jetë shporta e fundit e përcaktuar në përputhje me paragrafët 7.12 ose 7.13, dhe me t'u arritur marrëveshja sipas paragrafit 7.12 ose me t'u arritur një përcaktim nga ekspertët sipas paragrafit 7.13, do të bëhen përshtatjet e duhura (dhe çdo pagesë e duhur do të bëhet në përputhje me përcaktimin) brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas datës së marrëveshjes në fjalë apo përcaktimit të ekspertit, për të vendosur Palët në të njëjtin pozicion që do të kishin qenë, nëse do të kishin rënë dakord për shportën ose po të kishte qenë në fuqi shporta e ekspertëve gjatë periudhës në fjalë.

7.13 Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë para datës së prodhimit fillestar komercial dhe, më pas, në fillim të çdo tremujori kalendarik, Kontraktori do të përgatitë dhe t'i japë AKBN-së një parashikim të prodhimit që përcakton sasinë totale të hidrokarbureve të disponueshme që parashikohet se mund të prodhohet nga zona e Kontratës në secilin prej 4 (katër) tremujorëve kalendarikë pasardhës, bazuar në koeficientin e naftënxjerrjes të projektuar për të maksimizuar nxjerrjen përfundimtare të hidrokarbureve (koeficienti efikas maksimal) nga zona e Kontratës, në përputhje me praktikën përgjithësisht të pranueshme në industrinë ndërkombëtare të hidrokarbureve. Kontraktori do t'i kushtojë vëmendjen e duhur çdo komenti ose rekomandimi të bërë nga përfaqësuesit e AKBN-së në lidhje me këtë parashikim. Kontraktori do të përpiqet të prodhojë sasinë e parashikuar në çdo tremujor kalendarik.

7.14 Kontraktori do të ketë të drejtën të marrë veçmas në natyrë dhe të eksportojë të gjitha hidrokarburet për mbulim kostoje dhe hidrokarburet fitim, mbi të cilat ka të drejta sipas kësaj Kontrate. Kontraktori do të ketë të drejtën të transferojë lirshëm apo të mbajë jashtë Shqipërisë

të gjitha të ardhurat e siguruara prej tyre, duke përfshirë të ardhurat nga shitja e pjesës së vet të hidrokarbureve për mbulim kostoje dhe hidrokarbureve fitim, pavarësisht nëse këto shitje bëhen në Shqipëri apo nga hidrokarburet e eksportuara nga Kontraktori.

7.15 Në një kohë të arsyeshme, para datës së prodhimit fillestar komercial, dhe herë pas here, siç kërkohet më pas, AKBN-ja dhe Kontraktori do të takohen dhe bien dakord mbi një procedurë për të planifikuar marrjen e hidrokarbureve në pikën e matjes. Asnjë palë, as nuk do të fitojë, as nuk do të humbasë si rezultat i marrjeve nën një grafik të tillë. Liftimi nga Kontraktori gjykohet të konsistojë në radhë të parë në titullimin e plotë të Kontraktorit ndaj hidrokarbureve për mbulim kostoje, me qëllim që mbulimi i kostove, të mund të ecë në përputhje me këtë Kontratë dhe pjesa e mbetur e këtyre liftimeve gjykohet të konsistojë në hidrokarbure pas mbulimit të kostos.

Neni VIII Gazi

8.1 Nëse gazi (siç përcaktohet në paragrafin 1.44) prodhohet apo bëhet i prodhueshëm për shitje nga zona e Kontratës, AKBN-ja dhe Kontraktori do të konsiderojnë të gjitha alternativat e mundshme ekonomike për përdorimin e tij dhe do të vendosin bashkërisht për alternativën më të mirë për AKBN-në dhe Kontraktorin. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e këtij neni VIII, të aneksit D dhe do të respektohen dispozitat e ligjit 9946, datë 3.6.2008, "Për sektorin e gazit natyror".

8.2 Nëse Kontraktori bën një zbulim të gazit, procedurat e nenit VI do të zbatohen dhe do të ndiqen duke iu nënshtruar sa më poshtë. Nëse ka ndonjë zbulim gazi që Kontraktori e konsideron se mund të jetë zbulim komercial dhe ka mungesë apo papërshtatshmëri të një tregu të disponueshëm nga pikëpamja tregtare, të mundshëm për rezervat e gazit, kjo Kontratë do të pezullohet në lidhje me një zbulim të tillë gazi gjatë periudhës kohore në të cilën nuk ka filluar zhvillimi i rezervave të gazit, me kusht që një periudhë e tillë të mund të mos i kalojë 5 (pesë) vjet nga data e zbulimit përkatës të gazit (periudhë e pezullimit të gazit). Gjatë periudhës së pezullimit të gazit për një zbulim të tillë, Palët do të bëjnë përpjekjet e arsyeshme në mirëbesim për të hetuar dhe shqyrtuar tregjet që mund të zhvillohen në mënyrë komerciale për ato rezerva gazi dhe të



shqyrtojë, gjithashtu, nëse veprime apo modifikime reciprokisht të pranueshme mund të merren për të rezultuar në qenien e tij në një zbulim komercial. Gjatë çdo periudhë të pezullimit të gazit nën këtë paragraf 8.2, pjesa e zonës së Kontratës që përbën prospektin gjeologjik që përmban rezervat e gazit të zbulimit (zona e gazit e pezulluar) do të përcaktohet nga Kontraktori, në vartësi të miratimit nga AKBN-ja dhe nuk do t'i nënshtrohet heqjes dorë të detyruar në përputhje me nenin V këtu, as ndonjë dispozite tjetër të kësaj Kontrate, duke përfshirë pa kufizim, skadimin e periudhës së kërkimit. Me të filluar zhvillimi i zonës së gazit të pezulluar, periudha e pezullimit të gazit do të mbarojë dhe do të aplikohen dispozitat përkatëse të nenit VI. Kuptohet që, në rast se zhvillimi i zonës së gazit të pezulluar nuk ka filluar gjatë periudhës së pezullimit të gazit, Kontraktori do të heqë dorë nga zona e gazit e pezulluar.

8.3 Nëse botimet e çmimeve të referuara në nenin VII dhe aneksin D nuk arrijnë të botojnë ose nuk arrijnë të reflektojnë kushtet dhe/ose çmimet reale të tregut, kuotimet e naftës bruto dhe të produkteve do të merren nga ato tabela të botuara në një botim tjetër që vazhdon të botohet, i përshtatur siç bien dakord Palët, në mënyrë që t'u afrohet sa më afër rezultateve që do të ishin arritur nëse nuk do të kishte ndodhur një mungesë e tillë. Nëse botime të tilla nuk botohen më, Palët do të bien dakord për burime të tjera reference për çmimet.

8.4 Nëse ndonjë burim çmimi i referuar në nenin VII apo aneksin D do të botonte një ndryshim retrospektiv, në ngjitje apo në zbritje, për çdo çmim të naftës bruto apo produktesh që referohet në nenin VII ose në aneksin D, efekti i një ndryshimi të tillë në llogaritjen e çmimeve për çdo muaj kalendarik do të kufizohet me atë të muajit të mëparshëm ose të muajit të botimit të një ndryshimi retrospektiv.

Neni IX

Tatimet dhe taksat shqiptare

9.1 Kontraktori deklaron dhe paguan rentën minerare në përputhje me legjislacion në fuqi, "Për taksat kombëtare".

9.2 Secili prej enteve që përbën Kontraktorin, siç mund të rezultojë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, i nënshtrohen pagesës së tatimit mbi fitimin në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin

shqiptar dhe specifikisht në përputhje dhe dispozitat e këtij neni IX, në masën pesëdhjetë për qind (50%) të zbatueshme mbi pjesën e tyre të hidrokarbureve fitim, dhe

gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate çdo ent që përbën Kontraktorin i nënshtrohet veçmas tatimit mbi fitimin, në përputhje me ligjin nr. 7811, datë 12.4.1994, "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkimi dhe prodhimi)" i amenduar dhe do t'u përmbahen kushteve të tij.

9.3 Përqindjet e ndarjes së fitimit të rëna dakord, sipas paragrafit 7.6 të kësaj Kontrate, janë caktuar duke marrë në konsideratë që Kontraktori do t'i nënshtrohet një tatimi mbi fitimin shqiptar prej pesëdhjetë për qind (50%). Për këtë qëllim, Palët bien dakord që përqindja e tatimit mbi fitimin prej pesëdhjetë për qind (50%) do të fiksohet për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj Kontrate, në qoftë se kjo vlerë nuk do të zvogëlohet në përputhje me nenin 1, nënseksioni 3, të ligjit nr. 7811, datë 12.4.1994, "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkimi dhe prodhimi)" ose ligje apo rregulla të tjera në Shqipëri.

9.4 Në rastin që nuk ka të ngjarë të ndodhë, që përqindja e tatimit mbi fitimin e referuar në paragrafin 9.2, të rritet pavarësisht nga ligji nr. 7811, datë 12.4.1994, "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkimi dhe prodhimi)" dhe dispozitat e kësaj Kontrate, përqindjet e ndarjes së prodhimit, të caktuara sipas paragrafit 7.6 do të gjykohen të jenë modifikuar automatikisht, përkatësisht për të ruajtur ekuilibrin ekonomik të kësaj Kontrate në mënyrë që Kontraktori të marrë të njëjtën pjesë të hidrokarbureve fitim, sikur përqindja e tatimit mbi fitimin të kishte mbetur pesëdhjetë për qind (50%) (siç mund në të njëjtën mënyrë të reduktohet në përputhje me paragrafin 9.2 më sipër

Pavarësisht sa më sipër, palët bien dakord që legjislacioni "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve" prevalon këtë kontratë dhe çdo ndryshim i tij në lidhje me tatimfitimin është automatikisht i zbatueshëm pavarësisht klauzolave të kësaj Kontrate.

9.5 Në qoftë se gjatë zbatimit të kësaj Kontrate Kontraktori mund të përbëhet nga më shumë se një njësi, tatimi shqiptar mbi fitimin e secilit prej enteve që përbëjnë Kontraktorin do të paguhet në para tek autoriteti përkatës i qeverisë shqiptare, në përputhje me ligjet e aplikueshme shqiptare,



rregullat dhe procedurën e mëposhtme:

9.5.1 Secila prej enteve që përbëjnë Kontraktorin do të paguajnë tatimin shqiptar mbi fitimin për çdo tremujor kalendarik, në para, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga paraqitja tek AKBN-ja të situacionit të mbulimit të kostos për tremujorin përkatës kalendarik, siç kërkohet nga neni III i procedurës së kontabilitetit. Pagesa e rentës minerare do të bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”.

9.5.2 AKBN-ja do të sigurojë që Kontraktori ose çdo entitet që përbën Kontraktorin, të marrë faturën zyrtare për pagesën e taksës nga autoritetet e duhura tatimore shqiptare që tregon që tatimi shqiptar mbi fitimin është paguar nga Kontraktori në afat.

9.6 Përveç rentës minerare dhe tatimit shqiptar mbi fitimin, siç përshkruhet më sipër, çdo ent që përbën Kontraktorin, shoqëritë përkatëse filiale të tyre dhe personeli i huaj do të përjashtohen nga taksat, tarifatat, tatimet, detyrimet dhe pagesat shqiptare të çfarëdolloj natyre, duke përfshirë por pa u kufizuar në tatimin mbi vlerën e shtuar dhe taksën e akcizës të pagueshme në Shqipëri, në lidhje me të gjitha aktivitetet që lidhen me operacionet hidrokarbure, për aq sa parashikojnë ligjet shqiptare në fuqi në fazat e kërkimit. Këto përjashtime nuk përfshijnë pagesat normale portuale, të magazinimit dhe postale dhe detyrime të tjera të ngjashme klientele me aplikim të përgjithshëm për shërbimet faktike të kryera.

Pavarësisht sa më sipër, palët bien dakord që këto përjashtime fiskale do të jenë të zbatueshme për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe detyrimisht duhet të jenë në akordancë me legjislacionin në fuqi.

9.7 Kontraktori do t’u përmbahet kërkesave të ligjit shqiptar në lidhje me dokumentimin e të ardhurave, vlerësimin e tatimeve dhe mbajtjen për shqyrtim nga persona të autorizuar, të librave dhe regjistrave të llogarisë.

Neni X

Zyrtat dhe bërja e njoftimit

10.1 Kontraktori do të mbajë adresën zyrtare të shoqërisë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, QKR, në Shqipëri, në të cilën do të konsiderohen të dërguara në mënyrë të vlefshme njoftimet dhe do të njoftojë AKBN-në për çdo

ndryshim të Administratorit dhe adresës zyrtare të shoqërisë. Në rast të moskryerjes së këtij njoftimi, çdo njoftim i AKBN-së do të konsiderohet i kryer dhe i vlefshëm.

10.2 Gjithë çështjet dhe njoftimet që lihen me shkrim në zyrën e Palës përkatëse ose që merren nga një Palë e tillë, kur livrohen personalisht ose dërgohen me transmetim me *email*, postë dhe faks në zyrën kryesore të saj në Shqipëri, do të konsiderohen të jenë dhënë në mënyrë të vlefshme.

Neni XI

Ruajtja e hidrokarbureve dhe parandalimi i humbjeve

11.1 Kontraktori do të marrë të gjitha masat e duhura, sipas metodave përgjithësisht të pranueshme në përdorim në industrinë ndërkombëtare të hidrokarbureve për të parandaluar humbjet apo shpërdorimin e hidrokarbureve mbi ose nën tokë gjatë operacioneve të shpimit, prodhimit, grumbullimit dhe shpërndarjes apo stokimit.

11.2 Me përfundimin e shpimit të një pusi prodhimi, Kontraktori do të informojë AKBN-në për kohën kur do të testohet pusi dhe ritmet e prodhimit, pasi janë përcaktuar rezultatet.

Neni XII

Përjashtimi nga detyrimet doganore

12.1 Kontraktori dhe nënkontraktorët e tij të angazhuar në kryerjen e operacioneve sipas kësaj Kontrate, do të lejohen të importojnë dhe do të përjashtohen nga detyrimet doganore apo pagesat e tjera (me përjashtim të pagesave normale portuale e të magazinimit me aplikim të përgjithshëm në Shqipëri për shërbimet reale të bëra Kontraktorit) në lidhje me importimin e makinerive, pajisjeve, materialeve, duke përfshirë pa u kufizuar artikujt e konsumit, pasuritë e tundshme dhe pjesë këmbimi për secilën nga sa më sipër, për t’u përdorur në kryerjen e operacioneve hidrokarbure sipas kësaj Kontrate, sipas ligjit nr. 7811, datë 12 prill 1994, “Për aprovimin e dekretit nr. 782, datë 22.2.1994, “Mbi sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim prodhim)”, amenduar me ligjin nr. 8345, datë 13 maj 1998, “Për një ndryshim në ligjin nr. 7811, datë 12.4.1994, “Për aprovimin e dekretit nr. 782, datë 22.2.1994, “Mbi sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim prodhim)”. Kontraktori do të ndjekë hapat e procedurës ligjore, siç përcaktohen nga Drejtoria e Për-



gjithshme e Doganave Shqiptare, që janë të nevojshme për qëllimin e zbatimit të lejeve të importit dhe përjashtimet nga detyrimet doganore që i jepen Kontraktorit në këtë paragraf 12.1.

12.2 Secili punonjës i huaj i Kontraktorit dhe nënkontraktorëve të tij do të lejohet të importojë dhe do të përjashtohet nga të gjitha detyrimet doganore, licencat e importit dhe lejet e pagesat e tjera (me përjashtim të pagesave normale portuale e të magazinimit me aplikim të përgjithshëm në Shqipëri për shërbimet reale të bëra atyre) në lidhje me importimin e sendeve të përdorimit vetjak, me kusht që këto sende importohen vetëm për përdorimin e punonjësve dhe familjeve të tyre.

12.3 Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 12.1 nuk zbatohet për asnjë artikull importi kur artikuj të të njëjtit lloj apo substancialisht të të njëjtit lloj dhe cilësi prodhohen në vend dhe janë të disponueshëm për blerje dhe livrim në kohë në Shqipëri me një çmim jo më të lartë se kostoja e njërive të importuara para detyrimeve doganore, por pasi janë shtuar kostot e sigurimit dhe transportit.

12.4 Në vartësi të miratimit nga AKBN për sa u përket artikujve për të cilët është bërë mbulimi i kostos, secili prej artikujve të importuar në Shqipëri, i përjashtuar apo jo nga detyrimet doganore sipas këtij neni, që nuk u është shitur palëve të treta në Shqipëri në përputhje me paragrafin 12.5, mund të eksportohet nga pala importuese në çdo moment pas njoftimit në zyrën e doganave, pa pagesë të ndonjë takse, tarife eksporti apo pagese.

12.5 Në vartësi të miratimit nga AKBN-ja për sa u përket artikujve për të cilët është bërë mbulimi i kostos, të rinj apo të përdorur, por në gjendje pune, materiale, pajisje dhe mallra të përdorur në operacionet sipas kësaj Kontrate nga Kontraktori dhe objektet shtëpiake dhe artikujt vetjakë që i përkasin personelit të Kontraktorit mund të shiten brenda Shqipërisë; me kusht që blerësit të paguajnë detyrimet doganore të aplikueshme, nëse ka ose nëse i shiten ndonjë enti tjetër që gëzon të njëjtat të drejta përjashtimi si Kontraktori.

12.6 Në vartësi të miratimit nga AKBN-ja për sa u përket artikujve për të cilët është bërë mbulimi i kostos, materiale, pajisje dhe mallra të dëmtuar apo të përdorur që nuk janë në gjendje pune dhe që klasifikohen nga Kontraktori si mbeturinë apo si

hedhurinë, mund të shiten si mbeturina apo hedhurina pa pagesë të detyrimeve doganore nga Kontraktori.

12.7 Në rast të një shitje të tillë sipas paragrafit 12.5 (përveç objekteve shtëpiake, sendeve personale në pronësi nga punonjësit e Kontraktorit dhe nënkontraktorëve të tij) dhe 12.6 më sipër, të ardhurat nga një shitje e tillë do të ndahen në mënyrën e mëposhtme: Kontraktori do të ketë të drejtën të marrë të ardhurat, të ardhura të cilat (pa detyrimet doganore) kur merren do të reduktojnë koston e pambuluar, nëse ka, të cilën Kontraktori ka të drejtë ta mbulojë në përputhje me nenin VII këtu. Nëse nuk mbetet kosto për t'u mbuluar nga Kontraktori, atëherë të gjithë të ardhurat (pa detyrimet doganore) të këtyre shitjeve, nëse ka, do t'i paguhet AKBN-së.

12.8 Kontraktori përjashtohet nga detyrimi për licencim për eksport të naftës bruto nga institucioni përgjegjës për licencat sipas llojit, në lidhje me licencën e gazit natyror, sipas rastit, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9946, date 30.6.2008. Gjithashtu, Kontraktori përjashtohet dhe nga çdo detyrim, takse dhe detyrim financiar në lidhje me eksportin e hidrokarbureve nga Shqipëria, me përjashtim të taksës së rentës minerare, kur kjo e fundit, sipas legjislacionit në fuqi, parashikohet të paguhet në doganë në momentin e eksportit.

12.9 Kontraktori do të ndjekë hapat e procedurës ligjore, siç përcaktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Shqiptare, që janë të nevojshëm për qëllimin e zbatimit të të tilla përjashtimeve të parashikuara nga klauzolat 12.1-12.8 me sipër.

12.10 AKBN-ja do të bashkëpunojë me Kontraktorin me qëllim që të mundësojë operacionet e importit dhe eksportit, duke përfshirë procedurat e duhura të zhdoganimit sipas kësaj Kontrate.

Neni XIII

Librat e llogarive, kontabiliteti dhe pagesat

13.1 Kontraktori do të mbajë në zyrat e tij të biznesit në Shqipëri, librat e llogarisë, në përputhje me ligjin shqiptar, procedurën e kontabilitetit, praktikat e kontabilitetit të përdorura përgjithësisht në industrinë ndërkombëtare të hidrokarbureve dhe libra e regjistra të tjerë që mund të jenë të nevojshëm për të treguar punën e kryer sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë sasinë e të gjitha hidro-



karbureve të disponueshme. Kontraktori do të mbajë librat e llogarisë dhe regjistrat e llogarisë në dollarë amerikanë dhe lekë shqiptarë.

Në rast të ndonjë procedure arbitrazhi sipas nenit XXI të kësaj Kontrate, që përfshijnë librat e llogarisë në shqip të Kontraktorit, librat e llogarisë të mbajtura në përputhje me procedurën e kontabilitetit, të hartuara sipas legjislacionit shqiptar do të mbizotërojnë dhe në rastin kur mungojnë parashikimet në legjislacionin shqiptar do të kenë përparësi librat e llogarisë të hartuara në përputhje praktikat e industrisë ndërkombëtare të hidrokarbureve mbi pjesët e tjeratë librave.

13.2 Gjithë shpenzimet në dollarë do të regjistrohen në librat e llogarisë së Kontraktorit në sasinë e harxhuar. Gjithë shpenzimet në monedhë shqiptare do të konvertohen në dollarë me kursin zyrtar të blerjes të cituar nga Banka Shtetërore e Shqipërisë në ditën në të cilën janë paguar shpenzimet përkatëse. Gjithë shpenzimet e tjera jo në dollarë do të konvertohen në dollarë me kursin e blerjes së dollarit me atë monedhë siç citohet nga Citibank, Londër, Angli më 12:00 të mesditës, sipas kohës së Londrës, në ditën në të cilën është bërë shpenzimi përkatës dhe nëse kjo nuk është ditë që kryhen veprime bankare në Londër, në ditën tjetër pasardhëse bankare. Do të mbahen regjistrime të kurseve të këmbimit në konvertimin e shpenzimeve në monedhë shqiptare apo në valuta të ndryshme nga dollari, në dollarë. Kontraktori do të lejohet, gjithashtu, të mbajë dhe të përdorë lirshëm llogari bankare në dollarë jashtë Shqipërisë dhe në Shqipëri për qëllime të operacioneve të tyre sipas kësaj Kontrate.

13.3 Librat e lartpërmendur të llogarive dhe libra e regjistra të tjerë të referuar më sipër, do të mbahen në gjuhën shqipe dhe anglisht dhe do të jenë të disponueshëm në çdo kohë të arsyeshme për inspektim nga përfaqësuesit e autorizuar në mënyrë të rregullt të AKBN-së dhe të autoriteteve tatimore shqiptare.

Neni XIV

Përgjegjësia për dëmet

14.1 Kontraktori do të ushtrojë aftësi profesionale, kujdes dhe durim të arsyeshëm në përmbushjen e detyrimeve të tij në këtë Kontratë. Kontraktori do të mbajë përgjegjësi ndaj AKBN-së, nga kryerja e veprimeve apo mosveprimeve në

rastet e çdo neglizhence apo faji të demonstruar dhe kryerja e veprimtarisë së rrezikshme nga ana e Kontraktorit.

14.2 Në rast të ndonjë dëmi për të cilët Kontraktori është përgjegjës sipas këtij neni XIV, Kontraktori do të përpiqet për të marrë menjëherë dhe me kujdes masat e nevojshme, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe praktikat e mira të industrisë ndërkombëtare të hidrokarbureve, për të zbutur dëmin dhe për të rivendosur operacionet normale. Kontraktori, në përputhje me legjislacionin shqiptar, për dëmet për të cilat është deklaruar përgjegjës, do të jetë përgjegjës për të shlyer dëmin efektiv dhe fitimin e munguar.

14.3 Për shmangien e dyshimit, Kontraktori në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjës për dëmet rrjedhojë, domethënë, dëme që nuk janë rezultat direkt dhe imediat i veprimeve të Kontraktorit apo pamundësisë së tij për të vepruar, duke përfshirë humbjen e prodhimit apo humbjen e fitimeve.

14.4 Kontraktori, si pjesë e operacioneve hidrokarbure, do të mbajë sigurime në përputhje me legjislacionin shqiptar të zbatueshëm të cilat do të bëheshin nga çdo operator i arsyeshëm dhe i kujdesshëm në industrinë e hidrokarbureve, lidhur me operacionet e tij, duke përfshirë sigurimet për pasuritë, pronësia e të cilave do t'i kalojë AKBN-së, sipas nenit XXIII të kësaj Kontrate. Megjithatë, Kontraktori nuk do të ketë detyrim që të sigurojë pasuri pronësia e të cilave i ka kaluar AKBN-së, siç u përmend më sipër, kur pasuritë nuk përdoren më nga Kontraktori në operacionet hidrokarbure.

Neni XV

Dokumentacioni, raportet dhe inspektimi

15.1 Kontraktori do të përgatitë dhe, në çdo kohë gjatë së cilës kjo Kontratë është në fuqi, do të mbajë dokumentacion të saktë dhe në vazhdimësi të operacioneve të tij hidrokarbure sipas kësaj Kontrate. Kontraktori do t'i japë AKBN-së apo përfaqësuesve të saj të gjithë informacionin dhe të dhënat në lidhje me operacionet e tij hidrokarbure në Shqipëri, në kuadrin e kësaj Kontrate.

15.2 Nëse nuk bihet dakord ndryshe nga AKBN-ja, në rast të eksportimit të ndonjë kampioni shkëmbor jashtë Shqipërisë për analiza, kampione ekuivalente në përmasa dhe cilësi do të mbahen nga Kontraktori në Shqipëri.

15.3 Origjinalet e regjistrimeve të të dhënave teknike mund të eksportohen nga Kontraktori për



analiza jashtë; megjithatë, me kusht që shiritat manjetikë dhe çdo e dhënë tjetër që duhet të përpunohet apo analizohet jashtë Shqipërisë mund të eksportohet nëse një monitor apo një regjistrim i krahasueshëm mbahet në Shqipëri nga Kontraktori.

15.4 Kontraktori do t'i lejojë AKBN-së, nëpërmjet përfaqësuesve apo punonjësve të vet të autorizuar në mënyrë të rregullt, të kenë të drejtë të plotë hyrjeje në zonën e kontratës, në çdo kohë të arsyeshme, me të drejtën të vëzhgojnë operacionet që po kryhen dhe të inspektojnë dokumentacionin dhe të dhënat e mbajtura nga Kontraktori. Përfaqësuesit e AKBN-së, në ushtrimin e kësaj të drejte, në kuadrin e fjalisë paraprirëse të këtij paragrafi 15.4, do të kujdesen që të mos pengohen apo vonohen operacionet hidrokarbure.

15.5 Kontraktori do t'i japë AKBN-së rregullisht kopje, të gjithë dokumentacionit teknik (duke përfshirë, por pa u kufizuar në shiritat fushorë sizmikë, raportet gjeologjike e gjeofizike, karrotazhet dhe survejimet e puseve, informacion dhe interpretim të tyre) që janë në dispozicion të Kontraktorit, duke përfshirë testet e kampioneve, që lidhen me operacionet hidrokarbure në kuadrin e kësaj Kontrate. Gjithë këto të dhëna do të gjykohen të jenë tepër konfidenciale, dhe nuk do të ekspozohen nga AKBN-ja, përveç tek autoritetet e tjera qeveritare, pa miratimin e Kontraktorit, as nga Kontraktori, përveç shoqërive filiale, konsulentëve profesionalë, bankat apo institucionet financiare nga të cilët Kontraktori apo çdo entitet që përbën Kontraktorin, kërkojnë apo marrin financim dhe palët e treta që mund të jenë të interesuara në marrjen e një interesi nën këtë Kontratë (me kusht, gjithmonë, që shoqëri filiale të tilla, konsulente, banka, institucione financiare dhe palë të treta të jenë të detyruara nga një ndërmarrje strikte konfidencialiteti) ose në atë masë që kërkohet nga çdo bursë në të cilën kuotohen aksionet ose pjesë të kapitalit themelor të Kontraktorit, çdo entiteti që përbën Kontraktorin apo të ndonjë shoqërie filiale të Kontraktorit apo çdo entiteti që përbën Kontraktorin të kuotuar, me njoftimin paraprak të AKBN-së, sa kohë që kjo Kontrate është në fuqi. Nëse kjo Kontratë do të përfundohet në periudhën e parë të kërkimit apo çdo zgjatjeje të saj, Kontraktori do të jetë i detyruar të mos ekspozojë, përveç shoqërive filiale, të dhënat dhe informacionin e siguruar prej tyre dhe të mos i

dorëzojnë ato në asnjë lloj mënyre gjatë të paktën 5 (pesë) vjetëve nga mbarimi i kësaj Kontrate. Ndërmarrja e konfidencialitetit nga AKBN-ja nuk përfshin të dhëna mbi zonat e hequra dorë nga Kontraktori, të dhëna të cilat mund t'u jepen palëve të treta me kusht që marrësit e tyre të bien dakord t'i përdorin ato vetëm për të përcaktuar mundësinë e lidhjes së një kontrate për atë zonë me AKBN-në dhe t'i mbajnë të dhënat konfidenciale.

Neni XVI

Të drejtat e punësimit dhe kualifikimi i personelit shqiptar

16.1 Është dëshirë e Palëve që operacionet hidrokarbure nën këtë Kontratë të kryhen në mënyrë profesionale dhe efektive; për këtë qëllim, AKBN-në të asistojë që:

16.1.1 Personelit të huaj administrativ, profesionist dhe teknik të punësuar nga Kontraktori dhe personelit të nënkontraktorëve të tij për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, në kuadrin e kësaj Kontrate, do t'u jepet rezidencë dhe leje pune në Shqipëri, me kusht plotësimin në afat nga ana e tyre të dokumentacionit përkatës ligjor për dhënien e lejes së qëndrimit dhe lejes së punës.

16.1.2 Personeli i huaj administrativ, profesionist dhe teknik i punësuar nga Kontraktori, do të paguhet për shërbimet e tij në përputhje me politikën e Kontraktorit të aplikueshme për personelin në fjalë, që do të jenë në përputhje me praktikën e industrisë ndërkombëtare të hidrokarbureve.

16.2 Kontraktori do të jetë i lirë të zgjedhë punonjësit e tij dhe të përcaktojë numrin e tyre që do të përdoren për operacionet hidrokarbure në kuadrin e kësaj Kontrate në përputhje me praktikën e industrisë ndërkombëtare të hidrokarbureve. Pa paragjykim për sa më sipër, bihet dakord që:

16.2.1 Duke marrë parasysh kërkesat operacionale të Kontraktorit në kuadrin e kësaj Kontrate, Kontraktori do të punësojë personel shqiptar nëse aftësitë profesionale të tyre, njohuritë dhe eksperiencën janë të përshtatshme me kërkesat e Kontraktorit. Kontraktori do të sigurojë në mënyrë të arsyeshme që nënkontraktorët e tij të ndjekin këtë procedurë.

16.2.2 Gjatë prodhimit, Kontraktori do të zëvendësojë gradualisht personelin e tij të huaj joekzekutiv me personel të kualifikuar shqiptar, në bazë të disponibilitetit.



16.2.3 Në qoftë se, në përputhje me ligjin shqiptar të aplikueshëm, Kontraktorit i kërkohet që të mbajë çdo pagesë të taksave, sigurimeve shoqërore, dhe/ose sigurimet shëndetësore nga pagat e punonjësve shqiptarë ose nënkontraktorëve ose të kryejë të gjitha ose disa nga pagesat e sigurimeve shoqërore apo shëndetësore për punonjësit e tij shqiptarë, Kontraktori do t'i plotësojë këto kërkesa dhe, aty ku është e aplikueshme, t'i derdhë këto taksa dhe pagesa tek autoritetet përkatëse të qeverisë shqiptare.

16.3 Kontraktori do të përgatisë dhe do të realizojë programe kualifikimi për punonjësit shqiptarë të tij të angazhuar në operacionet hidrokarbure në kuadrin e kësaj Kontrate në lidhje me aspektet e aplikueshme të industrisë hidrokarbure.

16.4 Kontraktori do të bashkëpunojë me AKBN-në për programet e kualifikimit si më poshtë:

16.4.1 Kontraktori do t'i paguajë AKBN-së, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga fillimi i çdo viti kontraktual pesëmbëdhjetë mijë dollarë (15.000US\$) për vit kontraktual gjatë periudhës së kërkimit, për t'u përdorur për:

a) blerjen për AKBN-në të literaturës teknike të avancuar, të dhënave, *software*, *hardware* dhe pajisjeve teknike apo shërbimeve sipas kërkesës së AKB-së;

b) dërgimin e personelit të AKBN-së në kurse të zgjedhura në fushën e shkencave të hidrokarbureve, në inxhinieri dhe menaxhim; dhe

c) mbulimin nga AKBN-ja të shpenzimeve administrative lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate.

Në rast se këto periudha nuk fillojnë në fillim ose nuk mbarojnë në fund të një viti të plotë Kontraktual, këto fonde do të rillogariten respektivisht.

16.5 Gjithë kostot dhe shpenzimet e bëra nga Kontraktori në lidhje me programet e kualifikimit për punonjësit shqiptarë, do të mbulohen nga Kontraktori sipas nenit VII këtu, si shpenzime kërkimi.

Neni XVII

Kontraktorët vendas dhe materialet e prodhuara në vend

Kontraktori dhe nënkontraktorët e tyre:

17.1 Do t'u japin prioritet Kontraktorëve vendas për sa kohë që çmimet e tyre dhe cilësia e disponueshmëria e shërbimeve të tyre janë të

krahasueshme me çmimet dhe shërbimet ndër-kombëtare.

17.2 Do t'u japin preferencë materialeve, pajisjeve, makinerive dhe mjeteve të konsumit të prodhuara në vend, sa kohë që çmimi, cilësia dhe koha e livrimit të tyre janë të krahasueshme me materialet, pajisjet, makineritë, dhe mjetet e konsumit të disponueshme në tregun ndërkombëtar. Për qëllime të krahasimit të çmimeve, kostoja e artikujve të importuar do të përjashtojë detyrimet doganore, por do të përfshijë kostot e transportit dhe sigurimit.

17.3 Do t'ia nënshtrojë tenderit konkurrues në përputhje me politikën e operatorit, çdo kontratë me një vlerë të parashikuar mbi \$2,000,000 (dy milionë dollarë).

Neni XVIII

Ligjet dhe rregulloret

18.1 Kjo kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë dhe legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria. Palët me anën e kësaj kontrate heqin dorë nga zbatimi i çdo ligji tjetër në lidhje me Kontratën dhe marrëveshjen e arbitrazhit. Kontraktori do t'u nënshtrohet të gjitha ligjeve dhe rregullave të zbatueshme dhe në fuqi në Shqipëri, sikundër specifikohet në këtë nen XVIII.

18.2 Të drejtat dhe detyrimet e AKBN-së dhe Kontraktorit sipas dhe për kohën që është në fuqi kjo Kontratë, do të drejtohen nga dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe mund të ndryshohen apo amendohen vetëm me marrëveshje reciproke me shkrim të Palëve.

18.3 Nënkontraktorët e Kontraktorit do t'u nënshtrohen dispozitave të kësaj Kontrate të zbatueshme për ta dhe ata do t'u nënshtrohen, gjithashtu, të gjitha ligjeve dhe rregulloreve e amendamenteve të tyre me zbatim lokal.

18.4 Në rast se ndonjë dispozitë, ndryshim apo amendament të ri të ligjeve apo rregulloreve shqiptare apo ndonjë ndryshim në interpretimin e tyre, i imponon Kontraktorit atributë, tatime, detyrime, të drejta, pagesa apo detyrime të tjera të reja, në lidhje me ato që shprehimisht konsiderohen të aplikueshme për Kontraktorin ose nënkontraktorët e tyre sipas termave të kësaj Kontrate, Palët bien dakord që të amendojnë këtë Kontratë në mënyrë që përçindjet e ndarjes së fitimit të caktuara sipas paragrafit 7.6, të përshtaten



përkatësisht për të ruajtur ekuilibrin ekonomik të kësaj Kontrate, duke lejuar Kontraktorin të marrë të njëjtën pjesë neto të hidrokarbureve për ndarje fitimi sikur të mos kishin ndodhur ndryshime apo amendamente.

18.5 Nëse natyra e dispozitave, ndryshimeve, amendamenteve të reja apo interpretimi të referuara më sipër e bëjnë të pamundur praktikisht modifikimin e përqindjeve të ndarjes së fitimit të referuara në paragrafin 7.6, AKBN-ja dhe Kontraktori mund të bien dakord për ndonjë metodë tjetër të pranueshme dhe ligjore për të kompensuar Kontraktorin për barrën shtesë të ngarkuar mbi Kontraktorin, me kusht që kjo metodë alternative të ruajë ekuilibrin ekonomik të kësaj Kontrate sikur të mos kishin ndodhur ndryshime apo amendamente.

18.6 Për të përcaktuar rregullimin e përqindjes së ndarjes së fitimit apo metodën alternative për të kompensuar Kontraktorin referuar më sipër, AKBN-ja dhe Kontraktori do të takohen brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data në të cilën janë bërë ndryshimet apo amendamentet dhe çdo përshtatje e ndarjes së fitimit e përcaktuar sipas paragrafit 7.6 apo metodë alternative të kompensimit të Kontraktorit do të hyjë në fuqi retrospektivisht nga data e ngjarjes që motivoi përshtatjen.

Neni XIX

Kalimi i të drejtave dhe i detyrimeve

19.1 Kontraktori ose entet që përbëjnë Kontraktorin nuk mund të shesin, kalojnë apo t'i transferojnë në ndonjë mënyrë tjetër ndonjë personi, firmë apo shoqërie që nuk është Palë këtu, plotësisht apo pjesërisht, interesin e vet të pjesëmarrjes as ndonjë të drejtë, privilegj, detyrë apo detyrim tjetër sipas kësaj Kontrate pa miratimin me shkrim të AKBN-së, përveç një shoqërie filiale.

Çdo shitje, kalim apo transferim tjetër i lejuar të ndonjë person, firmë apo shoqëri, pa miratimin e nevojshëm do t'i kërkojë palës transferuese të bëjë përpjekjet më të mira për të ruajtur interesat e Palëve të tjera.

Kontraktori ose çdo ent që përbën Kontraktorin do të jetë i lirë të shesë, kalojë apo transferojë gjithë apo ndonjë pjesë të interesit të vet në këtë Kontratë një shoqërie filiale dhe për këtë do të njoftojë AKBN-në.

19.2 Në rast se Kontraktori ose çdo ent që përbën Kontraktorin, dëshirojnë të shesin, kalojnë apo përndryshe të transferojnë tërësisht apo pjesërisht interesin e vet këtu në ndonjë mënyrë tjetër nga siç lejohet më sipër pa miratim të AKBN-së, miratimi me shkrim për këtë i Palës tjetër nuk do të bllokohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme. Çdo shitje, kalim apo transferim tjetër i ashtuquajtur pa një miratim të tillë të AKBN-së do të jetë i pavlefshëm.

19.3 Çdo kalim i bërë në përputhje me dispozitat e këtij neni do të jetë i përjashtuar nga çdo taksë mbi të ardhurat, transferimin apo tatimin, detyrim apo pagesë tjetër që lidhet me të. Instrumenti i kalimit duhet të përmbajë dispozita që përcaktojnë saktësisht që i transferuari të jetë i detyruar nga gjithë kushtet që përmbahen në këtë Kontratë dhe çdo modifikim apo shtesë që është bërë deri në atë moment. Kur kërkohet miratimi i AKBN-së, një projekt i instrumentit të transferimit i dorëzohet AKBN-së për shqyrtim dhe miratim para se të nënshkruhet formalisht.

Neni XX

Forca madhore

20.1 Moskryerja apo vonesa në kryerje nga AKBN-ja dhe Kontraktori ose çdonjëri prej tyre, e ndonjë detyrimi sipas kësaj Kontrate do të falet nëse dhe në atë masë që kjo moskryerje apo vonesë është shkaktuar nga forca madhore. Periudha e një moskryerje apo vonese të tillë, së bashku me një periudhë të tillë që mund të jetë e nevojshme për restaurimin e çdo dëmi të bërë gjatë kësaj vonese, do t'i shtohet kohës së dhënë në këtë Kontratë për kryerjen e atyre detyrimeve që varen nga ato dhe për kohëzgjatjen e kësaj Kontrate.

Çdo Palë që pretendon forcën madhore sipas kësaj Kontrate do të njoftojë Palën tjetër sa më shpejt që të jetë e mundur pas ndodhjes së ngjarjes dhe do të japë të dhënat e veçanta dhe të arsyeshme për të.

20.2 Nëse ngjarja e forcës madhore ndodh gjatë periudhës së parë të kërkimit ose ndonjë prej periudhave të mëpasshme të kërkimit dhe vazhdon të jetë në veprim për një periudhë prej 1 (një) viti, Kontraktori do të ketë opsionin që, me njoftim paraprak me shkrim 90 (nëntëdhjetë) ditë para dërguar AKBN-së, të përfundojë këtë Kontratë, pa ndonjë përgjegjësi të mëtejshme të çfarëdolloji, me kusht që asnjë përfundim nuk do ta çlirojë



Kontraktorin nga ndonjë angazhim apo obligim i papërbushur dhe i mbartur përpara forcës madhore.

Neni XXI

Mosmarrëveshjet dhe arbitrazhi

21.1 Çdo mosmarrëveshje, kundërshti, pretendim ose ndryshim opiniononi, që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë ose thyerje, përfundim ose vlefshmëri e saj, ose për operacionet hidrokarbure të kryera sipas saj, do të vendoset përfundimisht nga arbitrazhi në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë Paris, Francë, ICC (rregullat).

21.2 Në lidhje me sa më sipër, autoriteti emërues, sipas rregullave, do të jetë Presidenti i Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, Francë.

21.3 Numri i arbitrave do të jetë tre. Pala që inicion arbitrazhin do të emërojë një arbitër dhe Pala tjetër do të emërojë një arbitër tjetër dhe në rast dështimi të kësaj pale për emërimin në këtë mënyrë të një arbitri brenda 30 (tridhjetë) ditësh, Pala që fillon arbitrazhin mund t'i kërkojë autoritetit emërues, emërimin e arbitrit të dytë, në përputhje me rregullat. 2 (dy) arbitrat e emëruar në këtë mënyrë do të zgjedhin arbitrin e tretë, që do të veprojë si arbitri kryetar i trupit gjykues.

21.4 Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga emërimi i arbitrit të dytë, 2 (dy) arbitrat e emëruar nuk arrijnë marrëveshjen për arbitrin e tretë, secila nga palët mund t'i kërkojë autoritetit emërues, të emërojë arbitrin e tretë.

21.5 Arbitrazhi do të zhvillohet në Londër, Mbretërinë e Bashkuar Angli. Gjuha që do të përdoret në procedurën e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze. Palët shprehimisht heqin dorë nga e drejta për të apeluar vendimin në çfarëdo gjykate dhe vendimi arbitral do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët.

21.6 Vendimi i arbitrazhit do të përmbajë arsyet mbi të cilat ai është bazuar dhe një vendim për kostot.

21.7 E drejta për t'iu drejtuar arbitrazhit sipas këtij neni XXI, do të vazhdojë edhe pas përfundimit të kësaj Kontrate.

21.8 AKBN-ja shprehimisht heq dorë nga çdo e drejtë për të deklaruar imunitet sovran në lidhje me çdo procedurë të filluar në përputhje me këtë nen XXI, çdo procedurë për të zbatuar me detyrim këtë

neni XXI ose çdo procedurë për të zbatuar çdo vendim të nxjerrë nga arbitrazhi sipas këtij neni XXI.

21.9 Gjykimi mbi vendimin e dhënë mund të bëhet nga çdo gjykatë që ka juridiksion ose aplikimi mund të bëhet në atë gjykatë për një pranim gjyqësor të vendimit dhe për urdhrin e ekzekutimit, sipas rastit.

21.10 Përveç sa parashikohet në paragrafin 7.13, çdo çështje në mosmarrëveshje ndërmjet AKBN-së dhe Kontraktorit, e cila sipas kushteve të kësaj Kontrate, duhet t'i referohet një eksperti, do t'i kalohet për përcaktim një eksperti të vetëm. Ekspertit do t'i jepen termat e referencës, për të cilët do të bihet dakord mes Palëve. Eksperti do të emërohet me marrëveshje mes AKBN-së dhe Kontraktorit. Në qoftë se AKBN-ja dhe Kontraktori dështojnë në emërimin e një Eksperti brenda tridhjetë (30) ditësh pas arritjes së marrëveshjes për termat e referencës, secila prej Palëve mund të aplikojë te Qendra e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë për ekspertizë teknike, Paris, Francë, për emërimin e një eksperti në përputhje me rregullat e saj. Eksperti do të bëjë përcaktimin e tij në përputhje me parashikimet që përmbahen këtu, bazuar në provat më të mira që ka në dispozicion. Përfaqësuesit e AKBN-së dhe Kontraktorit do të kenë të drejtë të konsultohen me ekspertin dhe t'i vënë atij në dispozicion të dhëna dhe informacion, duke mbajtur parasysh që eksperti mund të vendosë kufizime për këtë të drejtë. Çdo e dhënë dhe informacion i tillë duhet t'i jepet detyrimisht Palës tjetër në mosmarrëveshje, në të njëjtën kohë. Eksperti do të jetë i lirë të vlerësojë se sa çdo e dhënë, informacion apo provë tjetër është thelbësore apo e rëndësishme. Tarifa dhe shpenzimet e ekspertit dhe kostot e shoqëruara me emërimin e tij, në qoftë se ka, të bëra nga Qendra e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë për Ekspertizë Teknike, do të mbulohen në masë të barabartë nga AKBN-ja dhe Kontraktori. Përcaktimi i ekspertit do të jetë i detyrueshëm, por bëhet përfundimtar për palët vetëm në rast se brenda një afati 10-ditor nga dita që ka marrë njoftim nuk kundërshtohet nga asnjë nga palët. Nëse fillon një procedurë zgjidhje me ekspert, palët e kanë të ndaluar të procedojnë në të njëjtën kohë me arbitrazhin.



Neni XXII

Tubacionet dhe pajisjet e tjera

22.1 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate dhe çdo zgjatje të saj, Kontraktori ka të drejtën e përdorimit të plotë të zonës së Kontratës dhe çdo zone tjetër të miratuar nga AKBN-ja, të gjitha pasurive të tundshme dhe të patundshme të siguruara apo të marra nga Kontraktori për operacionet hidrokarbure.

22.2 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate dhe çdo zgjatje të saj, Kontraktori do të ketë të drejtën, për qëllimin e transportit të hidrokarbureve brenda apo nga zona e Kontratës në pikën e eksportit apo ndonjë pikë tjetër livrimi të rënë dakord nga AKBN-ja dhe Kontraktori, për të ndërtuar çdo tubacion dhe objekt që lidhet me to, si dhe objekte të tjera transporti dhe terminali brenda apo jashtë zonës së Kontratës, në përputhje me një program pune dhe buxhet zhvillimi. Ndërtimi i çdo objekti jashtë zonës së Kontratës nuk do të ndërhyjë në operacionet e AKBN-së apo të palëve të treta, do të bëhet në koordinim me AKBN-në dhe nuk do të bjerë në kundërshtim me politikën zhvillimore të miratuar të qeverisë shqiptare apo autoriteteve të tjera kompetente shqiptare.

22.3 Nëse Kontraktori dëshiron të përdorë ndonjë tubacion, objekte transporti e terminali që janë në dispozicion të AKBN-së dhe që nuk nevojiten për operacione të tjera hidrokarbure, AKBN-ja dhe Kontraktori do të takohen dhe bien dakord për kushte reciprokisht të kënaqshme për përdorimin e tyre bazuar në një tarifë të arsyeshme ekonomike.

22.4 Çdo pagesë e bërë nga Kontraktori për një përdorim të tillë do të jetë i mbulueshëm si shpenzime operative, sipas nenit VII.

Neni XXIII

E drejta e pronësisë mbi pasuritë dhe braktisja

23.1 E drejta e pronësisë mbi pasuritë e tundshme e të patundshme do të transferohet automatikisht dhe gradualisht nga Kontraktori tek AKBN-ja, mbasi kostoja e tyre t'i nënshtrohet rikuperimit sipas dispozitave të nenit VII dhe procedurës së kontabilitetit. Megjithatë, pronësia e plotë për pasuritë e tundshme dhe të patundshme do të transferohet automatikisht nga Kontraktori tek AKBN-ja kur të jetë mbuluar kostoja totale e tyre nga Kontraktori në përputhje me dispozitat e

nenit VII ose në kohën e përfundimit të kësaj Kontrate, cilado që të ndodhë më parë.

23.2 E drejta e pronësisë mbi pasuritë që nuk i nënshtrohen mbulimit të koston nga Kontraktori ose të importuara në Shqipëri nga personeli i huaj i Kontraktorit apo i nënkontraktorëve të Kontraktorit nuk do t'i transferohet AKBN-së dhe artikujt në fjalë, sipas zgjedhjes së pronarit të tyre, mund të shiten në Shqipëri, sipas paragrafit 12.5 ose të eksportohen lirshëm.

23.3 Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate dhe çdo periudhe zgjatjeje të saj Kontraktori ka të drejtën e përdorimit të plotë lirshëm në Shqipëri të gjitha pasurive të tundshme e të patundshme të siguruara apo të marra për operacionet hidrokarbure, pavarësisht nëse është mbuluar apo jo kostoja e tyre nga Kontraktori.

23.4 Kontraktori, me kërkesën e AKBN-së, do të heqë çdo instalim apo strukturë të ndërtuar nga Kontraktori për qëllime të kësaj Kontrate dhe që janë braktisur apo nuk përdoren me dhe për të cilat nuk ka perspektivë për përdorim në të ardhmen, gjatë kohëzgjatjes apo me zgjidhjen e kësaj Kontrate.

23.5 Në përputhje me termat e tij, detyrimet e lartpërmendura të heqjes dhe të braktisjes do t'i nënshtrohen dhe do të përcaktohen në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

i) Kontraktori, në konsultim me AKBN-në, do të përgatitë dhe dorëzojë në kohë tek AKBN-ja një plan braktisjeje (këtu më pas referuar si "Plan i braktisjes"), duke përfshirë një përshkrim të detajuar teknik dhe inxhinierik për masat e heqjes dhe braktisjes, në përputhje me detyrimet e lartpërmendura, që ai dëshiron të marrë me përfundimin e testimit, vlerësimit apo prodhimit nga zona e zhvillimit dhe prodhimit;

ii) jo më vonë se 180 ditë para datës së referuar, në "iii" më poshtë, Kontraktori do t'i dorëzojë AKBN-së për miratim prej saj një buxhet të detajuar (këtu më pas referuar si "Buxheti i braktisjes"), duke detajuar koston e parashikuar për Planin e Braktisjes.

iii) 10 (dhjetë) vjet para datës së parashikuar të përfundimit të operacioneve të prodhimit ose në fund të tremujorit në të cilin prodhimi kumulativ arrin shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të nxjerrjes së pritur të hidrokarbureve, cilado që të ndodhë më parë, një vlerë e barabartë me buxhetin e braktisjes do të shtohet në librat e llogarisë (këtu më pas të



referuara si “Llogaria e kostos së braktisjes”) për t’u përdorur për të mbuluar kostot e braktisjes. Kjo sasi do të jetë e mbulueshme nga Kontraktori në përputhje me nenin VII, për qëllime të të cilit vlera do të shpërmdahet proporcionalisht mbi bazën e njësisë së prodhimit gjate nxjerrjes së mbetur të pritur të hidrokarbureve nga zona e zhvillimit dhe prodhimit;

iv) në përvjetorin e parë të datës të referuar në “ii” këtu më lart, dhe mbi bazë vjetore më pas, Palët do të takohen të rivlerësojnë buxhetin e braktisjes të parashikuar dhe nëse është e nevojshme, do të rishikojnë këtë buxhet braktisjeje, në të cilin rast palët do të bien dakord, gjithashtu, për ndonjë përshtatje rrjedhojë që do t’i bëhet sasisë që do të vihet në llogarinë e kostos së braktisjes;

v) jo më vonë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë para datës së parashikuar të përfundimit të operacioneve hidrokarbure në lidhje me gjithë ose një pjesë të zonave të zhvillimit dhe prodhimit, Kontraktori do të përgatitë dhe dorëzojë tek AKBN-ja një plan përfundimtar braktisjeje me rishikimet, në përputhje me detyrimet e lartpërmendura të Kontraktorit. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga miratimi i planit të braktisjes në fjalë, Kontraktori do të përgatitë dhe dorëzojë tek AKBN-ja një buxhet braktisjeje përfundimtar. Nëse gjendja në llogarinë e kostos së braktisjes (këtu më pas e referuar si “Gjendja e kostos”) është e pamjaftueshme për të përmbushur buxhetin, një sasi e nevojshme për të plotësuar buxhetin e braktisjes do të regjistrohet në llogarinë e kostos së braktisjes dhe do të jetë e mbulueshme nga Kontraktori në përputhje me nenin VII;

vi) Kontraktori do të kryejë me kujdes operacionet e heqjes dhe braktisjes të specifikuara në planin e braktisjes dhe këto shpenzime do të reduktojnë llogarinë e kostos së braktisjes. Çdo diferencë e mbetur në llogarinë e kostos së braktisjes me përfundimin e operacioneve dhe e mbuluar në përputhje me nenin VII do t’i paguhet AKBN-së brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga përfundimi i operacioneve në fjalë.

23.6 Pa paragjykim ndaj klauzolave të paragrafëve 23.4 dhe 23.5, Kontraktori mund, nëse Kontraktori e mendon se ka kushte që nuk e sigurojnë vazhdimësinë e operacioneve hidrokarbure dhe në konsultim me AKBN-në, në çdo kohë, t’i japë AKBN-së njoftim me shkrim në një

afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh përpara për planet e saj për të hequr dorë nga të drejtat dhe detyrimet e saj në përputhje me këtë Kontratë, përveç atyre të drejtave dhe detyrimeve që janë grumbulluar në periudhën përpara kësaj heqje dore, si edhe atyre të drejtave dhe detyrimeve në vazhdimësi, siç përcaktohet në këtë Kontratë, dhe të braktisë zonën e kontratës në përputhje me planin e braktisjes të paraqitur dhe të aprovuar nga AKBN-ja, aprovim i cili nuk do të mbahet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

Neni XXIV

Zgjidhja e kontratës

24.1 Kjo Kontratë mund të zgjidhet nga Kontraktori duke dhënë njoftim me shkrim AKBN-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para, me kusht që asnjë zgjidhje nuk e liron Kontraktorin nga çdo angazhim i papërmbushur apo detyrim tjetër i lindur para kësaj zgjidhjeje. Nëse ndonjëra nga Palët nuk u përmbush ndonjë prej detyrimeve të përcaktuara në këtë Kontratë si pasojë e arsyeve të ndryshme nga forca madhore (duke përfshirë, por pa u kufizuar në dhënien me dijeni dhe me qëllim të informacionit fals Palës tjetër), Pala tjetër mund të jap një njoftim me shkrim për mospërmbushjeve të dhënave dhe punëve sizmike, përpunimi të dhënave, punë gjeologjike në terren më pas do të përdoret kundër Palës që nuk ka përmbushur detyrimet me synim për të zgjidhur Kontratën në fund të periudhës prej gjashtë (6) Muajsh, nëse nuk korrigjohet kjo mospërmbushje detyrimi në fjalë brenda kohës së dhënë.

24.2 Përveç sa më sipër, kjo Kontratë mund të përfundohet nga AKBN-ja duke dhënë njoftim me shkrim Kontraktorit, jo më vonë se 120 (njëqind e njëzet) ditë përpara, në rastet e mëposhtme:

a) në qoftë se Kontraktori ka kryer në mënyrë të përsëritur një shkelje materiale të detyrave dhe detyrimeve themelore të tij sipas kësaj Kontrate dhe është këshilluar nga AKBN-ja për synimin e AKBN-së për të zgjidhur Kontratën në përputhje me këtë dispozitë dhe Kontraktori nuk ka arritur të riparojë këtë shkelje brenda një periudhe të arsyeshme kohore; ose

b) në qoftë se Kontraktori nuk u përmbahet ndonjë vendimi përfundimtar që rezulton nga një procedurë arbitrazhi sipas nenit XXI këtu; ose

c) në qoftë se Kontraktori gjykohet i falimentuar nga një gjykatë kompetente ose, nëse ka më shumë



se një ent që përbën Kontraktorin, çdonjëri prej tyre është deklaruar i falimentuar nga një gjykatë kompetente ku enti apo entet e tjera nuk kanë marrë veprimet e duhura për të riparuar një situatë të tillë.

24.3 Me zgjidhjen e kësaj Kontrate, gjithë të drejtat dhe detyrimet e Palëve të specifikuar në këtë Kontratë do të marrin fund plotësisht, në vartësi të dispozitave të mëposhtme:

24.2.1 Që të drejtat dhe detyrimet e Palëve që lindin nga kjo Kontratë para kësaj zgjidhje të respektohen.

24.2.2 Që në rast të çdo mospërmbajtje dhe përgjegjësi të lindura para zgjidhjes prej çdonjërës prej Palëve në lidhje me çdo detyrim të përcaktuar në Kontratë, duhet të riparohet nga Pala fajtoresh.

24.4 Në rastin e një zgjidhje më të hershme në përputhje me paragrafët 24.1 ose kjo Kontratë do të përfundohet automatikisht në tërësinë e saj, në qoftë se e gjithë zona e Kontratës është liruuar ose periudha e zhvillimit dhe prodhimit ose çdo zgjatje e mëtejshme e saj ka përfunduar në përputhje me parashikimet e Kontratës.

24.5 Pavarësisht nga paragrafët 24.1 dhe 24.2, kjo kontratë do të zgjidhet automatikisht nëse Kontraktori:

24.5.1 Nuk fillon kryerjen e programit minimal të punës të periudhës së parë të eksplorimit brenda tre muajve nga data efektive;

24.5.2 Nuk hyn në periudhën pasardhëse tek eksplorimet sipas dispozitave të nenit 4;

24.5.3 Nuk paraqesin garanci bankare sipas kushteve të parashikuara në paragrafin 29.4 dhe format aneksin E.

Në këto raste AKBN-ja dërgon një shkresë Kontraktorit ku e njofton për zgjidhjen automatike.

Neni XXV

Mbrojtja e mjedisit

25.1 Pa paragjykimet në lidhje me paragrafin 5.6, Kontraktori do të veprojë në përputhje me ligjin shqiptar nr. 8934, datë 5.9.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjin nr. 8905, datë 6.6.2005, “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”; ligji nr. 8990, datë 23.1.2003, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, ligji nr. 9010, datë 13.02.2003, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” dhe ligji nr. 9108, datë 17.7.2003, “Për substancat dhe preparatet kimike” dhe rregulla të tjera për mjedisin siç mund të

publikohen; duke mbajtur parasysh që çdo ligj apo rregull i ri i nxjerrë ose çdo ndryshim në interpretimin apo aplikimin e ligjeve ekzistuese për mjedisin, që ndodh pas datës efektive, do të jetë subjekt i paragrafit 18.4.

Kontraktori do të adaptojë masa ndër-kombëtarish të pranuar ose minimizojë ndotjen në mënyrë të tillë që kjo ndotje të mos shkaktojë degradimin e cilësisë së jetës ose shëndetit të qenieve njerëzore, kafshëve dhe burimeve vegjetative.

25.2 Kontraktori është ekskluzivisht përgjegjës për të përdorur programe të pranuar ndërkombëtarish për t’u përpjekur për të eliminuar apo minimizuar ndotjen e mjedisit. Sa herë që Kontraktori nuk ka qenë në gjendje të shmangë ndotjen e mjedisit, ai do të jetë përgjegjës për të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të kthyer mjedisin e ndikuar nga ndotja, sa më shumë që të jetë e mundur, në kushtet që ai ka qenë në datën efektive dhe të riparojë çdo ndikim të rëndësishëm negativ mbi mjedisin të shkaktuar direkt nga operacionet, për aq sa kërkojnë ligjet dhe rregullat e aplikueshme shqiptare për industrinë e naftës dhe gazit dhe në përputhje me praktikën e mira të industrisë ndërkombëtare të naftës.

25.3 AKBN-ja mund të inspektojë dokumentacionin e Kontraktorit në lidhje me zbatimin e këtij neni XXV në çdo kohë të arsyeshme pas datës efektive dhe deri në 6 (gjashtë) muaj pas zgjidhjes së kësaj Kontrate.

Neni XXVI

Teksti shqip dhe anglisht

Versionet shqip dhe anglisht të kësaj Kontrate do të kenë të njëjtën vlerë dhe do të referohen në kuptimin apo interpretimin e kësaj Kontrate; megjithatë, në rast konflikti në një kuptim apo interpretim të tillë, do të mbizotërojë versioni anglisht.

Neni XXVII

Pagesa e bonuseve

27.1 Kontraktori do t’i paguajë AKBN-së, vetëm një herë, një bonus nënshkrimi në shumën totale prej tridhjetë mijë dollarësh amerikanë (US\$30,000) brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve mbas datës efektive.



27.2 Kontraktori do t'i paguajë AKBN-së një bonus prodhimi në naftë, sipas shkallës së mëposhtme:

Fillimi i prodhimit 1 000 fuçi;

Kur prodhimi arrin 15 000 fuçi/ditë 4 000 fuçi;

Kur prodhimi arrin 30 000 fuçi/ditë 10 000 fuçi;

Kur prodhimi arrin 45 000 fuçi/ditë 15 000 fuçi.

27.3 Çdo pagesë do të bëhet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita në të cilën prodhimi arrin secilën sasi të prodhimit ditor sipas shkallës së më sipërme.

Neni XXVIII

Miratimi nga qeveria, data efektive

Kjo Kontratë do të jetë e detyrueshme për palët që nga data efektive. AKBN-ja do t'i japë Kontraktorit një kopje të dokumentit që provon miratimin e kësaj Kontrate, prej Këshillit të Ministrave të qeverisë të Republikës së Shqipërisë, brenda 10 ditësh pune që nga dita kur ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare.

Neni XXIX

Të ndryshme

29.1 Përveçse sa parashikohet në nenin IX, përgjegjësitë dhe detyrimet në këtë Kontratë të enteve që përbëjnë Kontraktorin janë kolektive dhe individuale.

29.2 Dështimi i ndonjë Pale për të ushtruar ose ekzekutuar ndonjë të drejtë nën këtë Kontratë nuk do të kuptohet si një heqje dorë prej kësaj të drejte.

29.3 Kontraktori do të kompensojë qeverinë shqiptare, ministrinë dhe AKBN-ja dhe punonjësit respektivë, zyrtarët, nëpunësit, drejtorët dhe agjentët e tyre, prej çdo pretendimi nga palët e treta për plagosjet personale ose dëmtimin e pasurive që vijnë si pasojë e kryerjes së operacioneve hidrokarbure, pavarësisht se kryhen prej ose për Kontraktorin, duke përfshirë pa kufizim, shpenzimet e arsyeshme për këshillime dhe kostot direkte për mbrojtje, duke pasur parasysh megjithatë, që Kontraktori nuk do të jetë përgjegjës nën këtë paragraf, 29.3, për çdo humbje, pretendim ose plagosje të tillë ose dëmtim të shkaktuar ose që rezulton prej çdo veprimi neglizhent të punonjësve, zyrtarëve, drejtorëve apo agjentëve respektivë të qeverisë shqiptare, ministrisë ose AKBN-së.

29.4 Brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data efektive, Kontraktori do të bëjë ekzekutimin dhe do t'i dërgojë AKBN-së një garanci bankare në formën e dokumentit bashkëngjitur dhe të bërë pjesë të kësaj kontrate si aneks E. Në rast se Kontraktori vendos të hyjë në çdo njëerën prej periudhave pasuese të kërimit, Kontraktori do të ekzekutojë dhe dorëzojë AKBN-së, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas një vendimi të tillë, një garanci bankare që do jetë në përputhje të plotë me kushtet e Kontratës dhe formatit të përcaktuar në aneksin E, që është pjesë e kësaj Kontrate.

29.5 Në lidhje me garancinë bankare të referuar në paragrafin 29.4 më sipër, AKBN-ja, duke filluar 3 (tre) muaj pas datës efektive dhe më pas në intervale një- ose tremujore, siç do të bihet dakord midis Palëve, do t'i japë Kontraktorit një evidencë të shkruar me shpenzimet e bëra nga Kontraktori, gjatë periudhës tremujore të mbuluar nga kjo evidencë dhe të pranuar nga AKBN-ja si llogaritje ndaj plotësimit nga Kontraktori të detyrimit të tij të programit të punës për periudhën e parë të kërimit dhe, siç mund të jetë rasti, për periudhën e dytë dhe të tretë të kërimit. Me qëllim reduktimit e garancisë bankare në rastin e shpimit të një pusi, do të llogaritet vlera e detyrimit financiar për 1 ml shpim dhe çdo muaj garancia bankare do të reduktohet me vlerën korresponduese të metrazhit të shpimit gjatë atij muaji.

Në dëshmi të këtij dokumenti, kjo Kontratë është firmosur në mënyrë të rregullt nga Palët përkatëse këtu në datën e përcaktuar fillimisht më sipër.

MINISTRIA E ENERGETIKËS DHE
INDUSTRIË

Nga:

Titulli:

ALBANIDES ENERGY SHPK

Nga:

Titulli:



ANEKSI A PËRSHKRIMI I ZONËS SË KONTRATËS

Zona e Kontratës, e mbuluar dhe e prekur nga kjo Kontratë përbëhet, në datën efektive, nga zona e rrethuar nga linjat e mëposhtme, të treguar, gjithashtu, në hartën që përbën aneksin B:

KAFENJTË E BLOKUT 8 NË TOKË

420 05' 00" (N) ndërprerja e lartësisë gjeografike me kufirin e njohur ndërkombëtarish midis Shqipërisë dhe Malit të Zi.


2. 420 05' 00" (N) 190 45' 00" (E).

3. 420 00' 00" (N) 190 45' 00" (E).

4. 420 00' 00" (N) ndërprerja e lartësisë gjeografike me kufirin e njohur ndërkombëtarish midis Shqipërisë dhe Kosovës.

ANEKSI B HARTA E ZONËS Ë KONTRATËS

MAP OF THE CONTRACT AREA





ANEKSI C
PROCEDURA E KONTABILITETIT

Neni I
Dispozita të përgjithshme

1. Përkufizime

Përkufizimet që përmbahen në nenin I të Kontratës do të zbatohen edhe për këtë procedurë kontabiliteti dhe do të kenë të njëjtin kuptim.

2. Dokumentacioni kontabël

2.1 Kontraktori do të mbajë dokumentacionin kontabël në përputhje me nenin XIII të Kontratës dhe me praktikat përgjithësisht të pranueshme të kontabilitetit të përdorura në industrinë ndërkombëtare të hidrokarbureve.

2.2 Kontraktori do të hapë dhe mbajë dokumentacion të veçantë të identifikueshëm të kontabilitetit që mund të jetë i nevojshëm për të dokumentuar në mënyrë të plotë dhe të duhur, gjithë kostot në lidhje me Kontratën dhe gjithë kreditë e marra nga Kontraktorët në lidhje me operacionet hidrokarbure.

2.3 Librat e llogarisë do të mbahen në dollarë amerikanë dhe në lekë shqiptarë, në përputhje me paragrafin 13.2 të Kontratës. Çdo humbje apo fitim që rezulton nga këmbimi i monedhës së kërkuar për operacionet hidrokarbure të Kontraktorit ose nga konvertimet përkatëse nga një monedhë në tjetrën do t'u ngarkohet apo kreditohet kostove të mbulueshme.

3. Situacioni i aktiviteve

3.1 Kontraktori do t'i japë AKBN-së, sa më shpejtë që të jetë e mundur, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fundi i çdo tremujori kalendarik, një situacion të aktivitetit të kërkimit sipas paragrafit 4.8 të Kontratës. Ky situacion do të reflektojë gjithë debitimet dhe kreditimet që lidhen me shpenzimet e kërkimit për atë tremujor kalendarik, të përmbledhura në klasifikimin e specifikuar në nenin II të procedurës së kontabilitetit.

3.2 Kontraktori do t'i japë AKBN-së, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fundi i çdo tremujori kalendarik, një situacion të aktivitetit të zhvillimit sipas paragrafit 6.13 të Kontratës, që reflekton gjithë debitimet dhe kreditimet që lidhen me zhvillimin dhe prodhimin për atë tremujor kalendarik (shpenzimet e zhvillimit dhe shpenzimet operative) të përmbledhura në klasifikimet e duhura që tregojnë natyrën e tyre.

4. Auditimet dhe rregullimet

4.1 Çdo zë i kostos në një situacion të aktivitetit të kërkimit do të gjykohet në mënyrë përfundimtare si kosto e miratuar pas 3 (tre) muajsh në vijim të marrjes së atij situacioni nga AKBN-ja, nëse brenda 3 (tre) muajve në fjalë AKBN-ja nuk i përjashton nëpërmjet auditimit me shkrim të tyre në përputhje me paragrafin 4.8 të Kontratës. Në atë rast, AKBN-ja dhe Kontraktori do të bisedojnë në kohë dhe do të përpqen të arrijnë një zgjidhje, gjatë së cilës Palët në fjalë do të identifikojnë kostot e refuzuara dhe kostot e pezulluara që rezultojnë nga një revizion i tillë.

4.2 Çdo zë i kostos në një situacion të aktivitetit të zhvillimit do të gjykohet në mënyrë përfundimtare si kosto e miratuar pas 12 (dymbëdhjetë) muajsh në vijim të marrjes së atij situacioni nga AKBN-ja, nëse brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve në fjalë AKBN-ja nuk i përjashton nëpërmjet revizionimit me shkrim të tyre. Në rast se AKBN-ja bën përjashtime të tilla nëpërmjet revizionimit me shkrim, AKBN-ja dhe Kontraktori do të bisedojnë në kohë dhe do të përpqen të arrijnë një zgjidhje, gjatë së cilës Palët në fjalë do të identifikojnë kostot e refuzuara dhe kostot e pezulluara që rezultojnë nga një revizion i tillë.

4.3 AKBN-ja do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të kryer revizionet në një mënyrë që do të rezultojë sa më e pranueshme për Kontraktorin dhe operacionet hidrokarbure të Kontraktorit. Kontraktori do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme të bashkëpunojnë me AKBN-në dhe do të sigurojnë asistencën dhe lehtësitë e arsyeshme, siç mund të jetë e përshtatshme.



4.4 Gjithë rregullimet që rezultojnë nga një revizion i rënë dakord ndërmjet Kontraktorit dhe AKBN-ja do të korigjohen menjëherë në situacionin pasardhës së aktiviteteve nga Kontraktori dhe të raportuar tek AKBN-ja. Nëse do të lindë ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me një revizion, ajo do të diskutohet nga drejtuesit e financës së AKBN-së dhe Kontraktorit dhe, nëse nuk zgjidhet, zëri apo zërat objekt mosmarrëveshje do të zgjidhen nga eksperti dhe në rast mospranimi dhe kundërshtimi të konkluzioneve të ekspertit nëpërmjet arbitrazhit, siç parashikohet në nenin XXI të Kontratës.

5. Nëse një Palë nuk arrin të bëjë ndonjë pagesë sipas dispozitave të kësaj Kontrate brenda kohës së specifikuar për një pagesë të tillë, atëherë ajo Palë do të shtojë interesin për pagesën e vonuar me përqindje vjetore dy presje pesë për qind (2.5%) më të lartë se Kursi i London Interbank Borrowing Offered (LIBOR) për depozitat 3-mujore (tremujore) të dollarit amerikan, të cituar nga Zyra e Londrës e Citibank (ose ndonjë bankë tjetër që Palët mund të bien dakord) afërsisht në orën 11:00 paradite me orën e Londrës, për ditën apo ditët që do të zbatohet përqindja.

Neni II

Kostot, shpenzimet dhe harxhimet

Në varësi të dispozitave të Kontratës, Kontraktori do të mbartë dhe paguajë, vetëm dhe drejtpërdrejt apo përmes shoqërive filiale të tyre, kostot dhe shpenzimet e mëposhtme, kosto dhe shpenzime të cilat do të trajtohen dhe mbulohen nga Kontraktori në përputhje me nenin VII të Kontratës me kusht që ato të mos jenë bërë para datës efektive përveç atyre shpenzimeve që lidhen me një program pune për periudhën e kërkimit, siç bihet dakord nga AKBN-ja.

1. Pagesat për qeverinë

Gjithë pagesat, qiratë, tatimet, rinovimet dhe pagesat e zgjatjeve e pagesa të tjera të çdo lloji apo natyre paguar qeverisë nga Kontraktori sipas kushteve të Kontratës, përveç bonuseve të prodhimit të paguara në përputhje me nenin XXVIII të Kontratës.

2. Kostot e personelit

2.1 Pagat dhe rrogat e punonjësve të Kontraktorit të angazhuar drejtpërdrejt në operacionet hidrokarbure, duke përfshirë pjesën e pagës apo rrogës, proporcionalisht me kohën e harxhuar, e paguara punonjësve të huaj të Kontraktorit që caktohen përkohësisht dhe punësohen në këto operacione. Sipas këtij nënparagrafi 2.1, Kontraktori ka të drejtën të ngarkojë mbi bazë mujore koston e gjithë personelit të angazhuar në operacionet hidrokarbure.

2.2 Kostoja e Kontraktorit për lejet, pushimet, dietat për jetesën dhe strehimin, udhëtimin, bonuset dhe dieta të tjera të aplikueshme ndaj pagave dhe rrogave të punonjësve të ngarkueshme sipas nënparagrafit 2.1 dhe paragrafëve 11 dhe 12 të këtij neni II.

2.3 Shpenzimet apo kontributet e bëra në përputhje me ligjin apo tatimet e vëna nga autoritetet qeveritare që zbatohen për koston e punës së Kontraktorit apo pagat e rrogat, siç parashikohet në nënparagrafët 2.1 dhe 2.2 dhe paragrafët 11 dhe 12 të këtij neni II.

3. Përfitimet e punonjësve

Kostoja e Kontraktorit për planet e sigurimit të jetës në grup të punonjësve, shërbimin mjekësor, paafhtësinë, shtrimin në spital, pensionin, kursimet, dhe përfitimet të tjera të një natyre të ngjashme për punonjësit e huaj dhe punonjësit vendës, të gjitha ngarkohen sipas nënparagrafëve 2.1 dhe 2.2 dhe paragrafëve 11 dhe 12 të këtij neni II. Paketa e pagesave pasi punonjësi largohet nga puna do të bëhet me një përqindje fikse të zbatueshme mbi borderonë e pagave, e cila do të jetë e barabartë me një sasi ekuivalente me detyrimin për pagesat e sigurimeve shoqërore, siç kërkohet nga detyrimet e Kontraktorit sipas Kodit të Punës Shqiptar.

4. Materialet

Materialet, pajisjet dhe furnizimet e blera apo furnizuara nga Kontraktori për përdorim në operacionet hidrokarbure.

4.1 Blerja

Materialet dhe pajisjet e blera do të ngarkohen me çmimin e paguar nga Kontraktori pas zbritjes së



gjitha skontove të marra realisht nga Kontraktori apo shoqëritë filiale të tyre. Çmimi do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në kosto të tilla si pagesa e prokurimit palëve të treta, pagesat e inspektimit dhe speditimit, pagesat e agjentëve të eksportit, pagesat e transportit, pagesat e sigurimeve, pagesat e ngarkim shkarkimit, taksat e importit dhe të licencave dhe gjithë zërat e tjerë që zakonisht shoqërohen me prokurimin e materialeve dhe pajisjeve dhe taksat e aplikueshme.

4.2 Materialet e furnizuara nga Kontraktorët

Materialet që kërkohen për operacionet hidrokarbure do të blihen direkt sa herë që është praktikisht e mundur, përveç kur Kontraktori mund t'i importojnë këto materiale nga materialet stok të Kontraktorit apo të shoqërive filiale të Kontraktorit jashtë Shqipërisë sipas kushteve të mëposhtme:

4.2.1 Material i ri (kategoria A)

Materiali i ri i transferuar nga magazinat apo pronat e tjera të shoqërive filiale të Kontraktorit do të çmohet sipas kostonus minus çdo skonto të bërë, me kusht që kostoja e furnizimeve materiale të mos jetë më e lartë se çmimet ndërkombëtare për materiale të një cilësie të ngjashme të furnizuara me kushte të ngjashëm që mbizotërojnë në kohën kur u porositën këto materiale.

4.2.2 Materiale të përdorura (kategoritë B dhe C) që do të përdoren me miratimin e AKBN-së.

4.2.2.1 Materialet që janë në gjendje të mirë dhe të përdorshëm për ripërdorim pa u riparuar do të klasifikohen si kategoria B dhe çmohen me shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të çmimit të materialit të ri. Kjo kategori do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në materiale që kanë kaluar në një proces riparimi dhe janë restauruar në gjendje të plotë pune.

4.2.2.2 Materialet që nuk mund të klasifikohen si kategoria B, por që janë në gjendje pune për funksionin e tyre fillestar, por jo mjaft të përshtatshme për riparim, do të klasifikohen si kategoria C dhe çmohen me pesëdhjetë për qind (50%) të çmimit të materialit të ri.

4.4.4.3 Materiali që nuk mund të klasifikohet si kategori B ose C do të çmohet me një vlerë proporcionale me përdorimin e tij.

4.3 Çmimet premium

Sa herë që materiali nuk mund të sigurohet në pikat e zakonshme të furnizimit dhe me çmimet e specifikuar në nënparagrafët 4.1 dhe 4.2 të këtij paragrafi 4, për shkak të emergjencave kombëtare, grevave apo shkaqe të tjera të pazakonta, Kontraktori mund të paguajnë për materialin e kërkuar mbi bazën e kostove e shpenzimeve direkte të Kontraktorit të realizuara në prokurimin e këtyre materialeve, në përshtatjen e tyre për përdorim dhe në lëvizjen e tyre në vendpërdorim.

4.4 Garancia e materialeve të blera apo furnizuara nga Kontraktori

Kontraktori nuk garanton materialin. Garancia e vetme për materialin e blerë apo furnizuar nga Kontraktori është garancia e furnizuesit apo prodhuesit; në rast të materialeve difektoze, kreditimi do të kalohet siç merret nga ose në përputhje me garancinë e furnizuesit apo prodhuesit, kur rregullimi, për Kontraktorin, është bërë nga furnizuesi apo prodhuesi.

5. Transporti

Transporti i punonjësve, pajisjeve, materialeve dhe furnizimeve të nevojshme për kryerjen e operacioneve hidrokarbure. Ky përfshin gjithë kostot e transportit dhe rivendosjes së punonjësve, por vetëm në atë masë që mbulohen nga politikat e miratuara të Kontraktorit, duke përfshirë shpenzime udhëtimi për punonjësit dhe familjet e tyre në kohën e punësimit për udhëtimin nga vendi i origjinës në Shqipëri dhe anasjelltas. Këto kosto do të përfshijnë, gjithashtu, transportin e sendeve vetjake e pajisjeve shtëpiake dhe gjithë kostot e tjera të rivendosjes.

6. Shërbimet

6.1 Kostoja e konsulentëve, shërbimeve të kontraktuara dhe produkteve të prokuruar nga palët e treta.

Kostoja e shërbimeve teknike, profesionale e të tjera të siguruar nga shoqëritë filiale të Kontraktorit të realizuar në shtete të tjera jashtë Shqipërisë, do të konsistojnë në paga, rroga dhe pagesa në bordero e atyre punonjësve të shoqërive filiale të Kontraktorit që kryejnë shërbime në lidhje me operacionet hidrokarbure. Këto kosto, së bashku me shpenzimet administrative që shoqërohen me to, do të ngarkohen në përputhje me si më poshtë:



Ngarkesa dhe kredite, përqindja e ngarkueshme	
\$0 - \$ 5 milionë	5%;
\$5 milionë - \$10 milionë	3%;
më shumë se \$10	2%.

Këto sasi do të aplikohen në bazë viti mbi sasinë kumulative të ngarkesave dhe kreditimeve siç është raportuar në pasqyrën e aktiviteteve siç është referuar në nenin I, paragrafi 3. Pagesat do të mbulojnë, por nuk do të kufizohen në, llojet e mëposhtme të shërbimeve: inxhinierike, gjeologjike, gjeofizike, shëndetësore, mjedisit dhe të sigurisë, projektimit, kontabilitetit, financës, thesarit, taksës, ligjore, marrëdhënieve me punonjësit, administrimit, drejtimit ekzekutiv, përpunimit dhe blerjes së të dhënave dhe draftimit.

6.3 Për shërbimet e kryera nga pajisjet apo objektet që janë në pronësi apo jepen me qira ekskluzivisht nga shoqëritë filiale të Kontraktorit, kostoja që do të ngarkohet do të jetë në raport me koston e pronësisë dhe shfrytëzimit ose në lidhje me artikuj kryesorë, si sonda shpimi apo anije, në tarifa jo më të larta se ato që mbizotërojnë në industrinë ndërkombëtare të hidrokarbureve.

7. Dëmet dhe humbjet

Gjithë kostot dhe shpenzimet e nevojshme për të zëvendësuar apo riparuar dëmet apo humbjet e pësuar nga zjarri, përmytjet, stuhia, vjedhjet, aksidentet apo çdo shkak tjetër, që në mënyrë të arsyeshme është i pakontrollueshëm nga Kontraktori. Kontraktori do t'i japë AKBN-së një njoftim me shkrim të dëmeve apo humbjeve të pësuar sa më shpejt që të jetë e mundur pasi është marrë raporti për të njëjtën gjë nga Kontraktori.

8. Shpenzimet ligjore

8.1 Gjithë kostot dhe shpenzimet e gjyqeve apo shërbimet ligjore të nevojshme apo të përshtatshme për ruajtjen e interesit të Kontraktorit në zonën e Kontratës ose në kuadrin dhe në përputhje me Kontratën, duke përfshirë tarifën dhe shpenzimet e avokatit, siç parashikohet këtu më poshtë, së bashku me gjithë gjykimet e marra kundër Kontraktorit ose në llogari të operacioneve hidrokarbure dhe shpenzimet reale të kryera nga Kontraktori në sigurimin e dëshmimeve për qëllime të mbrojtjes kundrejt çdo veprimi apo pretendimi të paditur apo të nxitur kundrejt operacioneve hidrokarbure apo përmbajtjes së Kontratës, me kusht që këto shpenzime nuk lidhen me mosmarrëveshje që mbeten të pasuksesshme midis Kontraktorit dhe AKBN-së, si dhe çdo proces tjetër gjyqësor, kundrejt Kontraktorit që nuk ka lidhje me Kontratën dhe operacionet hidrokarbure.

8.2 Në rast se veprimet apo pretendimet trajtohen nga personeli jurist i Kontraktorit, pagesat e përshtatshme do të ngarkohen për bërjen e këtyre shërbimeve.

9. Tatimet dhe taksat

Gjithë taksat, detyrimet apo pagesat e çdo lloji e natyre të vlerësuar apo vjela mbi ose në lidhje me operacionet në kuadrin e kësaj Kontrate, përveç atyre të mbuluara nga neni IX i Kontratës.

10. Sigurimet dhe pretendimet

10.1 Primet e paguara për çdo detyrim publik, dëmtim prone dhe sigurime të tjera të bëra nga Kontraktori.

10.3 Gjithë zgjidhjet që lindin nga pretendimet e Kontraktorit kundrejt siguruesve, për siguracionin e bërë në përfitim të operacioneve hidrokarbure, do t'u kreditohen kostove të mbulueshme në muajin në të cilin janë marrë.

11. Administrata lokale/zyrat në vendburim

Pagat dhe shpenzimet e drejtuesve dhe punonjësve të tjerë të Kontraktorit, të vendosur në Shqipëri, që u shërbejnë operacioneve hidrokarbure, koha e të cilëve nuk i ngarkohet direkt operacioneve hidrokarbure dhe kostoja e mirëmbajtjes dhe përdorimit të zyrave të kërkimit dhe/ose prodhimit dhe nënzyrave të nevojshme (duke përfshirë objekte strehimi për punonjësit, nëse kërkohet) të përdorura në kryerjen e këtyre operacioneve hidrokarbure. Këto pagesa do të jenë në proporcion të barabartë për gjithë zonat e Kontratave, nëse është e aplikueshme dhe me kohën e harxhuar për zhvillimin e operacioneve hidrokarbure.



12. Pagesat për mbajtjen në magazinë

Në rast se kërkohen objekte magazinimi për të kryer operacionet hidrokarbure, gjithë kostot që nevojiten për të ngritur dhe mirëmbajtur magazinën dhe gjithë kostot e realizuara në trajtimin e materialeve në magazinë.

13. Shpenzime të tjera

Çdo kosto dhe shpenzim tjetër, të duhur dhe të përshtatshëm, duke përfshirë pa u kufizuar në, blerjen e të drejtave për pasuri të paluajtshme për operacionet e hidrokarbureve dhe shpenzimet e braktisjes, të bëra nga Kontraktori sipas programeve të punës dhe buxheteve ose për të zgjidhur situatat e emergjencës, të miratuara nga AKBN-ja.

14. Kreditimet

Përveç kreditimeve të tjera bërë llogarive në përputhje me Kontratën dhe këtë procedurë kontabiliteti, të ardhurat neto, kur merren, që lindin nga sa më poshtë, do t'u kreditohen kostove të mbulueshme në atë masë që kostot i debitoeshin fillimisht kostove të mbulueshme:

14.1 Të ardhurat e marra nga palët e treta për përdorimin e pasurive të Kontraktorit të përdorura ekskluzivisht në operacionet hidrokarbure; dhe

14.2 Qiratë, rimbursimet dhe kreditimet e tjera të marra nga Kontraktori, të aplikueshme ndaj çdo ngarkese që i është bërë kostove të mbulueshme;

14.3 Çdo rimbursim i marrë nga Kontraktori për furnizuesit/prodhuesit apo agjentët e tyre në lidhje me pajisjet apo materialet defekte kostoja e të cilave ishte ngarkuar fillimisht nga Kontraktori në llogari sipas Kontratës;

14.4 Kostot e mbuluara në kohë të eksportuara në përputhje me nenin 12.4 të kësaj Kontrate.

Të ardhurat nga gjithë shitjet e materialeve të tepërta të ngarkuara sasisë sipas Kontratës në përputhje me nenin 12.7.

Të ardhurat nga siguracionet.

15. Asnjë dublikim i debitimeve dhe i kreditimeve

Pavarësisht nga ndonjë dispozitë në kundërshtim me këtë procedurë kontabiliteti, synohet që nuk do të ketë asnjë dublikim të debitimeve apo kreditimeve në llogaritë e kësaj Kontrate.

Neni III

Mbulimi i kostos

1. Situacioni i mbulimit të kostos

Kontraktori do t'i japë AKBN-së sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas çdo tremujori kalendarik, një situacion të mbulimit të kostos për atë tremujor.

Në pritje të përfundimit të çdo revizioni dhe çdo zgjidhje apo arbitrazhi në përputhje me Kontratën, Kontraktori do të përgatisë direkt nga çdo situacion i aktivitetit të kërkimit dhe aktivitetit të zhvillimit, për çdo tremujor kalendarik, situacionin e mbulimit të kostos për atë tremujor. Gjithë përshtatjet e nevojshme që rrjedhin nga përfundimi i revizioneve dhe i zgjidhjeve (me çfarëdo mënyre) të përjashtimeve të revizionit do të llogariten siç lindin dhe në përputhje me Kontratën, nëpërmjet përfshirjes së tyre si debi apo kredi (siç është e përshtatshme) në situacionin tjetër të mbulimit të kostos për t'u përgatitur atëherë; megjithatë, asnjë kosto e refuzuar nuk mund të përfshihet në një Situacion të tillë.

Situacionet e mbulimit të kostos do të tregojnë sa më poshtë:

1.1 Seksioni 1 - Kostot totale

1.1.1 Kostot totale të mbartura nga tremujorët kalendarikë të mëparshëm.

1.1.2 Rishikime të reja (kostot e refuzuara dhe kostot e miratuara) të situacioneve të mëparshme të aktivitetit të kërkimit dhe zhvillimit, që do të hynë në fuqi në këtë situacion.

1.1.3 Shpenzime të reja kërkimi dhe zhvillimi dhe shpenzime operative për tremujorin kalendarik (që i nënshtrohen revizionit) nga situacionet e aktivitetit të kërkimit dhe zhvillimit.

1.1.4 Kostot totale, duke përfshirë ato që i nënshtrohen revizionit.



1.2 Seksioni 2 - Vlera e hidrokarbureve për mbulim kostoje (duke marrë në konsideratë ndonjë marrje të mëparshme të hidrokarbureve në sasi më të vogla sesa titullimi)

1.2.1 Vlera e naftës bruto për mbulim kostoje e marrë në natyrë dhe e disponuar nga Kontraktori për tremujorin kalendarik.

1.2.2 Vlera e gazit për mbulim kostoje të marrë në natyrë dhe e disponuar nga Kontraktori për tremujorin kalendarik.

1.2.3 Vlera totale e hidrokarbureve për mbulim kostoje (1.2.1 plus 1.2.2).

1.3 Seksioni 3 - Mbulimi i kostos

1.3.1 Kostot nga seksioni 1 të mbuluara nga vlera e hidrokarbureve për mbulim kostoje.

1.3.2 Mbartja e kostove të pambuluara, nëse ka.

1.4 Seksioni 4 - Hidrokarbure fitim

1.4.1 Vlera e naftës bruto fitim, nëse ka.

1.4.2 Vlera e gazit fitim, nëse ka.

1.5 Seksioni 5 - Llogaria e kostove të pezulluara

1.5.1 Kostot totale të pezulluara të mbartura nga tremujorët e mëparshëm kalendarikë.

1.5.2 Kostot neto të pezulluara të zgjidhura rishtas ose të identifikuar rishtas nga revizioni, gjatë tremujorit kalendarik.

1.5.3 Kostot totale të pezulluara të mbartura në tremujorin tjetër kalendarik (1.5.1 plus 1.5.2).

2. Pagesat

Nëse një situacion i mbulimit të kostos tregon një sasi të pagueshme AKBN, pagesa e asaj shume do të bëhet në dollarë brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas paraqitjes së atij situacioni.

3. E drejta e revizionit

AKBN-ja do të ketë një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh nga marrja e çdo Situacioni të Mbulimit të Kostos gjatë së cilës të revizionojë dhe të paraqesë kundërshtimin ndaj këtij Situacioni. AKBN-ja dhe Kontraktori do të bjerë dakord për çdo përshtatje të duhur si rezultat i një revizioni të tillë. Dokumentet mbështetëse dhe llogaritë do të jenë në dispozicion të AKBN-së gjatë periudhës 12-mujore (dymbëdhjetëmujore) në fjalë.

4. Llogaria e kontrollit të mbulimit të kostos

Kontraktori do të mbajë një llogari të kontrollit të mbulimit të kostos dhe një kundër llogari shlyerje për të kontrolluar në të sasinë e kostos që mbetet për t'u mbuluar, nëse ka, sasinë e kostos së mbuluar dhe Vlerën e Hidrokarbureve Fitim, nëse ka. Këto llogari do të përgatiten mbi bazën e (dhe të jenë në konsistencë me) situacionet e mbulimit të kostos të tremujorëve kalendarikë.

Neni IV

Rishikime të procedurës së kontabilitetit

Dispozitat e kësaj procedure të kontabilitetit mund të ndryshohen me marrëveshje unanime me shkrim të Palëve. Çdo Palë mund të kërkojë një rishikim të modifikimeve të mundshme. Nëse arrihet marrëveshje, një instrument amendimi, i cili do të përcaktojë datën efektive të një amendamenti të tillë, do të përgatitet dhe nënshkruhet nga Palët.



ANEKSI D

PROCEDURA E PËRCAKTIMIT TË BOE-së TË GAZIT DHE PËRCAKTIMI I ÇMIMIT TË GAZIT DHE GLN-së

1. Përkufizimet që përmbahen në nenin I të Kontratës adaptohen për këtë qëllim për t'u përdorur në këtë aneks dhe përfshihen këtu nëpërmjet referencës.

2. Në rast se AKBN-ja dhe Kontraktori hyjnë në kontrata të shitjes së gazit për përdorimin e gazit të prodhuar sipas Kontratës për shitje konsumatorëve jashtë Shqipërisë, kontratat në fjalë të shitjes së gazit do të përmbajnë dispozita të përdorura përgjithësisht në industrinë ndërkombëtare të hidrokarbureve. Çmimet që AKBN-ja dhe Kontraktori do të marrin për këtë gaz do të specifikohen në kontratat e shitjes së gazit.

3. Në rast se AKBN-ja dhe Kontraktori hyjnë në një kontratë për shitjen në Shqipëri të pjesës së Kontraktorit të gazit të prodhuar në kuadrin e Kontratës, kontrata në fjalë e shitjes së gazit do të përmbajë dispozita të përdorura përgjithësisht në industrinë ndërkombëtare të hidrokarbureve, duke përfshirë një angazhim për blerje afatgjatë nga AKBN-ja dhe livrimin nga Kontraktori të minimumit të vëllimit ditor të rënë dakord në përputhje me kufizimet teknike.

Palët do të negociojnë dhe do të përpiqen të hyjnë në një kontratë për shitjen e gazit që mbulon gazin (siç përkufizohet këtu) për shitje në tregun e brendshëm shqiptar. Palët do të bien dakord mbi përqindjen e gazit që është e disponueshme për shitje imediate në tregun e brendshëm shqiptar, megjithatë, me kusht, që gjithë gazi që do të shitet në tregun e brendshëm shqiptar sipas një kontrate të tillë të shitjes së gazit do të shitet me terma e kushte jo më pak të favorshëm se ata të disponueshëm për Kontraktorin në tregun ndërkombëtar, duke përfshirë termat dhe kushtet e mëposhtëm:

a) një kusht që kërkon datën fillestare të livrimit për gazin që do të shitet në tregun e brendshëm shqiptar që do të koincidojë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të datës fillestare të livrimit të parashikuar për livrimin e gazit në tregun ndërkombëtar;

b) një dispozitë që përcakton çmimin i cili nuk është më i vogël se çmimi që Kontraktori mund të merrte në tregun ndërkombëtar (të llogaritur mbi bazë ekuivalente BTU); dhe

c) një kusht që kërkon që blerësin/t e gazit të jenë përgjegjës për gjithë kostot, shpenzimet dhe detyrimet që shoqërohen me projektimin, konstruksionin, instalimin dhe shfrytëzimin e një tubacioni të gazit natyror dhe objektet që lidhen me të, të nevojshme për të vënë gazin në dispozicion për livrim në tregun e brendshëm shqiptar.

Megjithatë, lidhja e një kontrate shitje të gazit për shitjen apo përdorimin e gazit në tregun e brendshëm shqiptar, në asnjë rast nuk do të rrezikojë apo pengojë aftësinë e Kontraktorit për të hyrë në një kontratë të shitjes së gazit në tregun ndërkombëtar. Në rast se kontratat e propozuara apo të ofruara të shitjes së gazit për tregun e brendshëm shqiptar nuk përmbushin apo plotësojnë gjithë termat apo kushtet e mësipërm, Kontraktori do të ketë të drejtën e pacenueshme të hyjë në një kontratë shitje të gazit që mbulon pjesën e vet të plotë të gazit në tregun ndërkombëtar.

3.1 Çmimi fillestar i gazit që AKBN-ja do t'i paguajë Kontraktorit do të jetë mesatarja e çmimeve të paguar për gazin e livruar në Itali për periudhën 6-mujore (gjashtëmujore) deri në datën e prodhimit fillestar komercial të gazit, siç citohet në tabelën e listuar si *European Border Prices* në botimin e mirënjohur të cituar botërisht *World Gas Intelligence*, që botohet nga *Petroleum & Energy Intelligence Weekly, Inc.*, në lidhje me vlerën kalorifike bruto.

3.2 Çmimi fillestar i gazit do të jetë efektiv për muajin e parë kalendarik të prodhimit pas datës së prodhimit fillestar komercial dhe për muajin e pjesshëm që paraprin këtë muaj të parë kalendarik nëse data e prodhimit fillestar komercial nuk është në ditën e parë të një muaji kalendarik.

3.3 Çmimi që AKBN-ja apo blerësi i caktuar i saj do t'i paguajë Kontraktorit për pjesën e tij të këtij gazi për çdo muaj të livrimit pas muajit të parë kalendarik të prodhimit pas datës së prodhimit fillestar komercial do të jetë mesatarja e çmimeve të paguara për gazin e livruar në Itali për periudhën 6-mujore (gjashtëmujore) para muajit të livrimit, siç citohet në tabelën e listuar si *European Border Prices* në botimin e mirënjohur të cituar botërisht *World Gas Intelligence*, që publikohet nga *Petroleum & Energy Intelligence Weekly, Inc.*, në lidhje me vlerën kalorifike bruto.



3.4 Çmimi që AKBN-ja apo blerësi i caktuar i saj do t'i paguajë Kontraktorit për pjesën e tij të këtij gazi do të paguhet në dollarë brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas fundit të një muaji kalendarik për gazin e livruar nga Kontraktori në muajin paraardhës kalendarik.

4. Zbulimi komercial i gazit në kuadrin e Kontratës nga Kontraktori dhe ekzekutimi i një kontrate shitje të gazit me AKBN-në mund të çojë, nëse e bëjnë të nevojshme kushtet e tregut, në fillimin e diskutimeve në lidhje me zbatimin e një projekti të gazit të lëngët (LPG). Çdo diskutim i tillë dhe plan rezultues do të përmbushë termat e Kontratës.

SHTOJCA E
FORMA E GARANCISË BANKARE
PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE

Ne, _____, bankë e nivelit të dytë, regjistruar Shqipëri, kemi marrë informacion se Albanides Energy sh.p.k. ka lidhur një Marrëveshje me ndarje prodhimi për zonën 8 Alpet e Shqipërisë, me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë së Shqipërisë, e cila ka hyrë në fuqi në datën _____ (në vijim si "PSC") dhe kuptojmë se, sipas dispozitave të PSC-së, kërkohet pagesa e një garancie.

Gjithashtu, kemi marrë informacion se sipas kushteve të PSC-së, Albanides Energy sh.p.k. ka marrë përsipër gjatë periudhës së parë të kërkimit të zbatojë planin e punës në zonën kontraktore (e gjitha e përshkruar në PSC) e për këtë arsye të shpenzojë shumën prej një milion e katërqind mijë dollarë amerikanë (\$ 1.400.000).

Me kërkesë të Albanides Energy sh.p.k., në, [•] Banka, Banka e nivelit të dytë në Shqipëri,[•] (adresa), me anë të kësaj kontrate garantojmë dhe angazhohemi t'ju paguajmë si bond garanci të shumës së investimit, të cilat në totalin e tyre nuk e tejkalojnë shumën US\$ 1.400.000 (një milion e katërqind mijë dollarë amerikanë) të fazës së parë të kësaj Marrëveshje, Marrëveshje me ndarje prodhimi, me marrjen nga ana jonë të kërkesës së parë me shkrim, sipas procedurës së pretendimit që jepet me detaje më poshtë.

Kërkesa Juaj duhet të paraqitet me anë të një letre dhe duhet të shoqërohet nga:

i) Kopje e njoftimit të AKBN-së drejtuar Albanides Energy sh.p.k. (që duhet të ketë datën e të paktën 30 ditë para datës së kërkesës) ku informohet Albanides Energy sh.p.k. mbi shkeljen e detyrimeve sipas planit të punës në bazë të Kontratës (PSC) natyrën dhe masën e shkeljes, si edhe synimin e AKBN për të kërkuar pagesën sipas kësaj garancie në rast se shkelja nuk ndreqet brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të saj; dhe

ii) Deklaratë të nënshkruar të AKBN-së ku deklarohet se Albanides Energy sh.p.k./nuk ka ndrequr shkeljen e përcaktuar në njoftim, brenda afatit të caktuar në njoftim dhe se nuk ka filluar asnjë procedurë për zgjidhje konflikti si para ekspertit ashtu edhe para çdo forumi tjetër për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në bazë të Kontratës (PSC).

Çdo kërkesë sipas kësaj kontrate dhe dokumentet që përcaktohen më lart duhet të dorëzohen në adresat e lartpërmendura në përputhje me procedurën e sipërpërmendur të pretendimit në apo përpara datës së mbarimit të afatit të kësaj garancie siç përshkruhet më poshtë, datë pas së cilës kjo garanci nuk do të prodhojë më asnjë lloj efekti.

Kërkesa e dërguar me faks nuk do të pranohet.

Kjo garanci do të hyjë në fuqi jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e efektive e hyrjes në fuqi të PSC-së dhe do të mbetet në fuqi, cilado datë është më e hershme:

a) përfundimi i periudhës së parë të kërkimit; dhe

b) datës kur shuma totale e kësaj garancie do të jetë tërhequr apo zvogëluar siç përcaktohet në paragrafin e mëposhtëm vijues.



Shuma e kësaj garancie do të zvogëlohet, do të bëhet në momentin e paraqitjes së një deklaratë me shkrim nga ana e AKBN-së mbi kostot dhe shpenzimet e njohura dhe certifikuar prej saj. Këto deklarata do të njoftohen dhe do të lëshohen nga ana e AKBN-së çdo 3 muaj.

Kjo garanci është personale dhe nuk mund të transferohet apo cedohet (përveçse me pëlqimin tonë paraprak me shkrim që nuk do të refuzohet pa shkak).

Kjo garanci është subjekt i rregullave standardë për kërkesë të garancive, publikim ICC nr. 758 dhe në masën që kjo nuk kundërshton këtë, kjo do të rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me ligjin shqiptar, e vendi i juridiksionit do të jetë Londër, Angli.

Kjo garanci do të do të hyjë në fuqi deri në nn fuqi deri në njëqind e tetëdhjetë ditë pas hyrjes në fuqi të PSC-së dhe do të mbetet në fuqi, cilado datë është më e hershme.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë